



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 124

Tiranë – E hënë, 21 gusht 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 61/2023, datë 21.7.2023	Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së <i>cannabis</i> -it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale..... 15047
Ligj nr. 69/2023, datë 21.7.2023	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 53/2019, “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”..... 15065
Dekret i Presidentit nr. 190, datë 14.8.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 15065
Udhëzim i ministrit të Brendshëm nr. 121, datë 14.8.2023	Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet, për kryetar të Bashkisë Kukës..... 15066
Urdhër i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 177, datë 2.8.2023	Për miratimin e përkthimit në gjuhën shqipe të ndryshimeve në Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit (SNK) 12 – “Tatimi mbi të ardhurat”..... 15068
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, datë 11.7.2023	Çështja Yzeiraj kundër Shqipërisë (<i>kërkesa nr. 70455/10</i>)..... 15071
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, datë 11.7.2023	Çështja Muçaj kundër Shqipërisë (<i>kërkesa nr. 37814/10</i>)..... 15073
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, datë 20.7.2023	Çështja Dea 7.Co Kundër Shqipërisë, <i>kërkesa nr. 65320/09</i> 15077
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, datë 20.7.2023	Çështja Hamitaj kundër Shqipërisë (<i>kërkesa nr. 11254/11</i>)..... 15079

Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, datë 20.7.2023	Çështja Safet Selimaj kundër Shqipërisë, <i>kërkesa nr. 27039/10</i>	15082
---	--	-------

Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër nr. 160, datë 8.6.2023	Me objekt përfundimin e procedurës së falimentimit të debitorit NEKU sh.p.k.....	15083
---	--	-------



LIGJ
Nr. 61/2023

**PËR KONTROLLIN E KULTIVIMIT
DHE PËRPUNIMIT TË BIMËS SË
CANNABIS-IT DHE PRODHIMIT TË
NËNPRODUKTEVE TË SAJ PËR
QËLLIME MJEKËSORE
DHE INDUSTRIALE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Objekti

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për kultivimin, prodhimin dhe qarkullimin e kontrolluar të bimës së *cannabis*-it, nënprodukteve të saj dhe produkteve përfundimtare për përdorim mjekësor dhe industrial.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është rregullimi dhe garantimi i procesit të kontrollit e të mbikëqyrjes së kultivimit, prodhimit dhe qarkullimit, si dhe eksportimin e bimës së *cannabis*-it, të nënprodukteve të saj dhe produkteve përfundimtare për qëllime mjekësore dhe industriale.

Neni 3

Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, me termat e mëposhtëm nënkuptohet:

1. “Aktivitet i licencuar” është çdo veprimtari e natyrës tregtare, ekonomike e profesionale që ushtrohet nga subjektet e licencuara për importimin e farës ose fidanit të bimës së *cannabis*-it, kultivimin,

prodhimin, transportin, si dhe eksportin e nënprodukteve e të produkteve përfundimtare të *cannabis*-it për qëllime mjekësore.

2. “Aktivitet i lejuar” është çdo veprimtari e natyrës tregtare, ekonomike e profesionale, që ushtrohet nga subjektet e lejuara për importimin e farës ose fidanit të bimës së *cannabis*-it, kultivimin, prodhimin, transportin, si dhe eksportin e nënprodukteve e të produkteve përfundimtare të *cannabis*-it për qëllime industriale.

3. “Bimë *cannabis* për qëllime industriale” është bima e *cannabis*-it, që përfshin të gjitha pjesët e freskëta ose të thata të bimës dhe farat e llojit *cannabis sativa* dhe *cannabis ruderalis* të varieteteve që përmbajnë jo më shumë se 0,8% THC, e cila kultivohet për qëllime industriale.

4. “Bimë *cannabis* për qëllime mjekësore” janë bimët e varieteteve të ndryshme, të variacioneve dhe nënlojeve të *cannabis sativa*, *cannabis indica* dhe *cannabis ruderalis*, të përfutuara nga kultivimi për qëllime mjekësore dhe kërkime shkencore në kushte të kontrolluara, sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj.

5. “*Cannabis*” janë majat e lulëzuara dhe të frutifikuara të bimëve të gjinisë *cannabis*, duke përfshirë farërat dhe gjethet kur këto nuk janë të shoqëruara me majat prej të cilave nuk është hequr rrëshira, pavarësisht nga emri që ato mund të kenë.

6. “Gjurmueshmëria” është procesi i gjurmimit dhe ndjekjes së farërave, fidanëve, substancave, bimëve, lëndëve dhe përgatesave, që janë objekt i këtij ligji, në të gjitha fazat e mbjelljes, kultivimit, prodhimit të nënprodukteve dhe produktit përfundimtar, tregtimit e furnizimit deri te përdoruesi fundor.

7. “Kultivim” është procesi që nis nga mbjellja e farërave ose fidanëve deri në vjeljen e bimës së *cannabis*-it.

8. “Mbetjet e bimës së *cannabis*-it” janë pjesë të bimës së *cannabis*-it të kultivuar për qëllime mjekësore ose mbetjet e tyre pas prodhimit dhe përpunimit, të cilat trajtohen si të panevojshme.

9. “Nënprodukt për qëllim industrial” janë materialet e përfutuara nga e gjithë bima e *cannabis*-it, duke përfshirë kërcellin, lulen dhe farën, i cili prodhohet për qëllime industriale, të cilat përfshijnë, por nuk kufizohen në përdorime për sektorin e ndërtimit, tekstilit, kozmetikës, prodhimit të energjisë, prodhimit të letrës etj.



10. “Nënprodukte për qëllime mjekësore” janë lëndët dhe përgatesat që nxirren nga bima e *cannabis*-it, që përdoren për përgatitjen e produkteve përfundimtare në të cilat përfshihen barnat dhe produktet kozmetike.

11. “Njësi prodhimi” është:

a) një sipërfaqe toke nga 5 deri në 10 hektarë, e rrethuar, në të cilën lejohet kultivimi i bimës së *cannabis*-it për qëllime mjekësore, ku përfshihen edhe magazina dhe ambientet e tjera të posaçme, në funksion të proceseve që lidhen me kultivimin e bimës së *cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve për qëllime mjekësore;

b) një sipërfaqe toke jo më e vogël se 1 hektar në të cilën lejohet kultivimi i bimës së *cannabis*-it për qëllime industriale, ku përfshihen edhe magazina, edhe ambientet e tjera të posaçme, në funksion të proceseve që lidhen me kultivimin e bimës së *cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve të bimës së *cannabis*-it për qëllime industriale.

12. “Përgatesë” është ekstrakti, përzierja ose lënda bimore e papërpunuar, e përfutur nga bima e *cannabis*-it, në gjendje të ngurtë ose të lëngët, ose në çfarëdo gjendjeje tjetër, i cili përmban bar narkotik ose substancë psikotrope.

13. “Prodhim” është procesi që merret me përgatitjen, përpunimin, përzierjen, pastrimin dhe çdo aktivitet tjetër me të cilin synohet të përftohen produktet dhe nënproduktet e bimës së *cannabis*-it për qëllime mjekësore dhe për qëllime industriale.

14. “Produkt përfundimtar për qëllime mjekësore të bimës së *cannabis*-it” është bari narkotik, substancat psikotrope dhe produktet kozmetike.

15. “Produkt përfundimtar për qëllime industriale të bimës së *cannabis*-it” është çdo produkt që ka në përbërje të tij bimë të *cannabis*-it për qëllime industriale.

16. “Qarkullim” është çdo mënyrë e kalimit në qarkullimin civil të bimës së *cannabis*-it, nënprodukteve dhe produktit përfundimtar të saj përkundrejt shpërbërimit, duke përfshirë importin, eksportin, tranzitimin, furnizimin, blerjen, shitjen, shkëmbimin, ruajtjen dhe magazinimin.

17. “Shenjim” është procesi i vendosjes së një shenje unike në formë kodi, pulle, etikete ose çdo formë tjetër unike shenjimi në farërat, fidanët, substancat, bimët e *cannabis*-it, nënproduktet ose produktet përfundimtare të saj, që provon se kultivimi është kryer sipas rregullave të përcaktuara

në këtë ligj, me qëllim identifikimin dhe gjurmimin e saj.

18. “Verifikimi i pastërtisë së figurës së punonjësit” është një proces verifikimi, shqyrtimi dhe vlerësimi, që i referohet kryerjes së një kontrolli paraprak, të kujdesshëm dhe kritik për përshtatshmërinë e personit që punësohet në Agjencinë Kombëtare të Kontrollit të *Cannabis*-it apo nga subjekti i licencuar sipas këtij ligji.

Neni 4

Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet për çdo subjekt që kryen veprimtari të licencuar për:

a) importin e farës ose fidanit apo riprodhimin e tyre;

b) kultivimin e bimës së *cannabis*-it mjekësor ose industrial;

c) prodhimin e nënproduktit ose produktit përfundimtar;

ç) qarkullimin e bimës së *cannabis*-it, nënproduktit ose produktit përfundimtar.

2. Ky ligj zbatohet edhe për çdo strukturë shtetërore që kryen mbikëqyrjen, kontrollin dhe inspektimin e zbatimit të këtij ligji.

Neni 5

Ndalime të përgjithshme

Në Republikën e Shqipërisë është i ndaluar:

a) kultivimi i bimës së *cannabis*-it mjekësor dhe prodhimi i nënprodukteve dhe produkteve përfundimtare të saj në tejkalim të dispozitave të këtij ligji;

b) kultivimi i bimës së *cannabis*-it dhe prodhimi i nënprodukteve dhe produkteve përfundimtare të saj për qëllime mjekësore, tregtimi dhe posedimi i tyre nëse nuk janë të shenjuara dhe të gjurmueshme sipas përcaktimeve në këtë ligj;

c) posedimi i mjeteve, pajisjeve dhe instrumenteve për prodhim të bimës së *cannabis*-it mjekësor dhe nënprodukteve dhe produkteve përfundimtare të saj, përveç rasteve të deklaruara nga subjekti i pajisur me licencë, të parashikuara në këtë ligj;

ç) përdorimi i nënprodukteve dhe produkteve përfundimtare të bimës së *cannabis*-it, përveç rasteve të parashikuara në këtë ligj dhe në legjislacionin e posaçëm në fuqi;



d) shitja dhe shpërndarja me pakicë apo shumicë, përvetësimi ose konsumi në territorin e Republikës së Shqipërisë i nënprodukteve ose produkteve përfundimtare për qëllime mjekësore;

dh) reklamimi i bërë në formë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, ose në çfarëdo mënyre tjetër, pavarësisht mediumit të publikimit, të veprimtarisë së importimit të farës ose fidanit të *cannabis*-it dhe kultivimit, prodhimit, shitjes, posedimit dhe përdorimit të bimës së *cannabis*-it mjekësor.

Neni 6

Procesi i verifikimit të pastërtisë së figurës

1. Mund të punësohen në cilësinë e punonjësit të Agjencisë ose në subjektet e licencuara apo të lejuara, sipas parashikimeve të këtij ligji, vetëm personat që kalojnë procesin e verifikimit të pastërtisë së figurës.

2. Për realizimin e procesit të verifikimit të pastërtisë së figurës së punonjësve të Agjencisë, si dhe të personave të përfshirë si të punësuar nga subjektet e licencuara apo të lejuara sipas parashikimeve të këtij ligji, Agjencia bashkëpunon me Policinë e Shtetit dhe autoritetet apo institucionet përgjegjëse që mbajnë apo administrojnë të dhënat për këtë qëllim.

3. Procesi i verifikimit të pastërtisë së figurës përfshin kriterin e integritetit moral, si dhe kriteret e veçanta etiko-profesionale për pozicione specifike të punës.

4. Procedurat, afatet, kriteret dhe dokumentacioni i nevojshëm për verifikimin e pastërtisë së figurës përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për shëndetësinë, ministrit përgjegjës për bujqësinë dhe ministrit përgjegjës për çështjet e brendshme dhe sigurinë, me propozimin e drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë.

KREU II

KRIJIMI, ORGANIZIMI, FUNKSIONIMI DHE KOMPETENCAT E AGJENCISË

Neni 7

Krijimi, statusi dhe financimi i Agjencisë

1. Agjencia Kombëtare e Kontrollit të *Cannabis*-it, këtu e në vijim Agjencia, është person juridik publik buxhetor në varësi të ministrit përgjegjës për shëndetësinë, që ka si mision mbikëqyrjen,

kontrollin dhe inspektimin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *cannabis*-it, dhe të prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore e industriale, dhe monitorimin e zbatimit të këtij ligji.

2. Agjencia organizohet dhe funksionon në nivel qendror, me seli në Tiranë, dhe e shtrën veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Burimet e financimit të Agjencisë janë të ardhurat nga buxheti i shtetit dhe të ardhurat e krijuara nga veprimtaria e saj në bazë dhe për zbatim të këtij ligji. Procedura dhe mënyra e përdorimit të të ardhurave përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Agjencia ka stemën, logon dhe vulën zyrtare. Stema përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet: “Republika e Shqipërisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjencia Kombëtare e Kontrollit të *Cannabis*-it”.

5. Vula e Agjencisë ka formën dhe elementet përbërëse, të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi për prodhimin, administrimin, kontrollin dhe ruajtjen e vulave zyrtare.

Neni 8

Drejtimi dhe organizimi

1. Agjencia drejtohet nga drejtori i përgjithshëm, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e institucionit dhe përgjigjet përpara ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

2. Pranë Agjencisë krijohet dhe funksionon Komisioni i Licencave, me qëllim mbështetjen e saj në ushtrimin e kompetencave, në përputhje me rolin dhe detyrat që ka sipas parashikimeve të këtij ligji.

3. Struktura dhe organika e Agjencisë miratohen me urdhr të Kryeministrit, me propozimin e ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

4. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të Agjencisë rregullohen sipas Kodit të Punës.

5. Punonjësi i Agjencisë duhet të ketë integritet dhe figurë të pastër morale. Ai nuk duhet të ketë qenë i dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për një vepër penale të kryer në fushën e narkotikëve.

6. Personat që punësohen në Agjencinë Kombëtare të Kontrollit të *Cannabis*-it, krahas kërkesave të përgjithshme, duhet të plotësojnë edhe kriteret për pastërtinë e figurës, si dhe kriteret e veçanta profesionale për pozicione specifike pune.



7. Verifikimi i kriterëve të pastërtisë së figurës zbatohet ndaj personit që kërkon të punësohet në Agjenci, si dhe për lidhjet e tij me personat e familjes ose jashtë saj. Personat që nuk plotësojnë kriterin e pastërtisë së figurës, nuk mund të lidhin ose të vijojnë të kenë marrëdhënie pune me Agjencinë.

8. Kriteret profesionale për punonjësit e Agjencisë, si dhe të verifikimit të figurës së punonjësve të subjekteve të licencuara përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për çështjet e brendshme dhe sigurinë, ministrit përgjegjës për bujqësinë dhe ministrit përgjegjës për shëndetësinë, me propozimin e drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë.

Neni 9

Kompetencat e Agjencisë

1. Agjencia ushtron kompetencat e saj në bazë të parimeve të ligjshmërisë, profesionalizmit, përgjegjësisë, llogaridhënies, efikasitetit dhe transparencës, dhe në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2. Agjencia, në ushtrimin e veprimtarisë së saj në nivel administrativ, ka këto kompetenca:

a) organizon procedurat për dhënien e licencës, sipas rregullave të përcaktuara në këtë ligj dhe rregullave të përcaktuara nga ministri përgjegjës për shëndetësinë;

b) mbikëqyr veprimtarinë e subjekteve të licencuara dhe të lejuara, në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në licencën dhe lejen për kultivimin e bimës së *cannabis*-it për qëllime mjekësore dhe industriale;

c) harton standardet për zonat dhe parcelat e tokës në të cilat do të lejohet kultivimi i bimës së *cannabis*-it për qëllime mjekësore dhe industriale, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për bujqësinë;

ç) harton çdo 3 vjet raportin, në lidhje me përmbushjen e kushteve të dhënies së licencave dhe lejeve, dhe rekomandon, sipas rastit, plotësimin e kushteve apo pezullimin ose shfuqizimin e licencave e të lejeve;

d) bashkëpunon me organet e tjera kompetente, me qëllim realizimin e objektivave dhe detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare ku është palë Republika e Shqipërisë;

dh) paraqet raporte përpara organizatave kompetente ndërkombëtare për importin dhe

eksportin e bimës së *cannabis*-it dhe të nënprodukteve ose produkteve përfundimtare të saj, në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga konventat ndërkombëtare për kontrollin e lëndëve narkotike dhe psikotrope;

e) bashkëpunon në vazhdimësi me Qendrën Evropiane për Monitorimin e Drogërave dhe Varësisë ndaj tyre dhe Bordin Ndërkombëtar për Kontrollin e Narkotikëve;

ë) kryen verifikimin e pastërtisë së figurës së çdo punonjësi të Agjencisë dhe të subjekteve të licencuara apo të lejuara, sipas përcaktimeve të këtij ligji, në bashkëpunim me autoritetet apo institucionet përgjegjëse që mbajnë apo administrojnë të dhënat për këtë qëllim. Verifikimi i figurës kryhet në momentin e angazhimit të personit, si dhe në mënyrë periodike, sipas parashikimeve të udhëzimit të përbashkët, të përmendur në nenin 8 të këtij ligji;

f) bashkëpunon me agjencitë e zbatimit të ligjit dhe strukturat shtetërore për ruajtjen e pastërtisë së figurës së punonjësve të subjekteve të licencuara apo të lejuara, si dhe parandalimin e veprave penale;

g) mban dhe administron regjistrat, bazën e të dhënave dhe statistika në nivel kombëtar sipas parashikimeve të këtij ligji;

gj) lëshon autorizimin e eksportit për *cannabis*-in industrial dhe produktet e *cannabis*-it për qëllime industriale;

h) harton rregullore, udhëzime dhe metodologji për unifikimin e proceseve dhe standardeve të punës së punonjësve të Agjencisë dhe ia propozon për miratim ministrit përgjegjës për shëndetësinë;

i) i propozon ministrit përgjegjës për bujqësinë dhe ministrit përgjegjës për mjedisin zonat kadastrale ku do të kultivohet *cannabis*-i për qëllime industriale;

j) jep masat administrative me gjobë dhe ndalim të ushtrimit të veprimtarisë ndaj subjekteve të licencuara dhe subjekteve të lejuara, sipas këtij ligji;

k) vlerëson kërkesat për shitjen e aksioneve të ortakëve të subjekteve mbajtëse të licencës apo lejes dhe ia propozon për miratim, pas miratimit të Komisionit të Licencave, ministrit përgjegjës për shëndetësinë për licencat dhe ministrit përgjegjës për bujqësinë për lejet.

3. Agjencia, në ushtrimin e veprimtarisë së saj, në nivel teknik, ka këto kompetenca:

a) mbikëqyr përdorimin dhe mbjelljen nga subjektet e licencuara të farërave dhe fidanëve të importuar apo të prodhuar në Republikën e



Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor, si dhe të regjistruar në katalogun kombëtar;

b) harton standardet për çdo fazë të procesit të lidhur me kultivimin e bimës së *cannabis*-it, të cilat miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për bujqësinë.

c) bashkërendon punën me autoritetet përgjegjëse shtetërore për kryerjen e regjistrimit dhe përfshirjen e menjëhershme në katalogun kombëtar të farërave dhe fidanëve, që janë të shoqëruara me testimin dallueshmëri-uniformitet-stabilitet (DUS);

ç) mbikëqyr dhe monitoron mbjelljen dhe kultivimin e bimës së *cannabis*-it dhe nënprodukteve të saj, që përdoren për qëllime mjekësore dhe industriale dhe, nëse konstaton që subjekti ka mbjellë ose ka kultivuar sasi të ndryshme nga ato të parashikuara në leje ose licencë, vendos asgjësimin e tyre dhe propozon sanksionet përkatëse;

d) kontrollon dhe inspekton të gjitha proceset e kultivimit të bimës së *cannabis*-it në çdo fazë të mbjelljes, korrijës, tharjes, ruajtjes dhe magazinimit, prodhimit të lëndës së parë bimore;

dh) kontrollon dhe inspekton, në bazë të licencës, ambientet dhe selitë ku bëhet përpunimi i nënprodukteve dhe produkteve përfundimtare për qëllime mjekësore;

e) merr masa për sekuestrimin dhe asgjësimin e bimëve të *cannabis*-it apo nënprodukteve të tij, sipas parashikimeve të këtij ligji;

ë) bashkëpunon me strukturat përgjegjëse për doganat për të monitoruar regjimin e importit të farërave e të fidanëve, si dhe regjimin e eksportit të nënprodukteve ose produkteve përfundimtare të *cannabis*-it mjekësor dhe industrial;

f) kryen çdo veprimtari tjetër të parashikuar nga ligje të tjera apo aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 10

Funksionet e Agjencisë

1. Agjencia mbikëqyr aktivitetin e licencuar dhe të lejuar në çdo fazë dhe për çdo cikël prodhimi për të siguruar që aktiviteti:

a) kryhet në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatimin e tyre, me përcaktimet e bëra në licencë ose leje, si dhe me përcaktimet në planin e miratuar të prodhimit;

b) nuk kryhet në kundërshtim me qëllimet e ligjit dhe me detyrimet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë.

2. Agjencia kryen mbikëqyrje, kontrolle dhe inspektime sipas këtij ligji dhe, kur është nevoja, koordinon procesin në bashkëpunim me institucione të tjera.

3. Në përmbushje të detyrave të veta, të kontrollit, inspektimit dhe monitorimit sipas parashikimeve të këtij ligji, Agjencia shkëmben informacion me prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, Prokurorinë e Posaçme/Byronë Kombëtare të Hetimit, Policinë e Shtetit, si dhe autoritetet e tjera kompetente në zbatim të këtij ligji, si dhe mund të nënshkruajë marrëveshje bashkëpunimi dy ose shumëpalëshe me to.

4. Agjencia, kryesisht apo me kërkesë, kryen verifikime në përputhje me parashikimet e këtij ligji. Pas kryerjes së verifikimit, nëse vlerësohet nga Agjencia marrja e masave për pezullimin apo shfuqizimin e licencës, ia përcjell për shqyrtim Komisionit të Licencave.

5. Agjencia bashkëpunon dhe shkëmben informacion me Policinë e Shtetit dhe institucione të tjera kombëtare apo ndërkombëtare, me të cilat Shqipëria ka marrëveshje në fushën e luftës ndaj përdorimit, trafikut të narkotikëve dhe substancave psikotrope, dhe ndaj pastrimit të të ardhurave prej aktivitetit të paligjshëm.

6. Agjencia mbledh dhe administron të dhëna të nevojshme për ushtrimin e funksioneve të saj mbi aktivitetin e licencuar dhe të lejuar, si dhe për titullarin e licencës ose lejes. Të dhënat parësore dhe dytësore përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas parashikimeve në pikën 6, të nenit 13 të këtij ligji.

7. Agjencia paraqet raport 6-mujor të punës pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, i cili i bëhet me dije edhe ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë.

8. Agjencia ushtron çdo funksion tjetër të përcaktuar në ligj ose në rregulloren për funksionimin e saj. Rregullat për organizimin e brendshëm të Agjencisë miratohen nga ministri përgjegjës për shëndetësinë.

9. Agjencia miraton rregulloret e veprimtarisë së subjekteve të licencuara.



Neni 11

Komisioni i Licencave

1. Pranë Agjencisë ngrihet Komisioni i Licencave, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave të paraqitura për marrjen e licencës, për kultivimin e *cannabis*-it, për qëllime mjekësore, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

2. Komisioni ka 7 anëtarë dhe ka këtë përbërje:

a) 3 përfaqësues nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë;

b) 1 përfaqësues nga ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike;

c) 2 përfaqësues nga ministria përgjegjëse për bujqësinë;

ç) 1 përfaqësues nga ministria përgjegjëse për ekonominë.

3. Kryetari i Komisionit është njëri nga përfaqësuesit e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë. Emrat nominalë të anëtarëve të Komisionit të Licencave caktohen me urdhër të ministrave përkatës.

4. Ministrat, sipas parashikimit të pikës 2, mund të caktojnë si anëtarë persona që ushtrojnë funksione publike që kanë lidhje me funksionin dhe detyrat e këtij Komisioni, dhe kanë jo më pak se 5 vjet përvojë pune. Anëtarët e Komisionit caktohen për një periudhë deri në 4 vjet.

5. Anëtarët e Komisionit kanë detyrim dhe nënshkruajnë deklaratën e konfidencialitetit, deklaratën e mungesës së konfliktit të interesit, si dhe duhet të jenë të pajisur me certifikatën e sigurisë nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

6. Komisioni i Licencave ka këto detyra:

a) administron dhe verifikon dokumentacionin e paraqitur nga subjektet që kanë bërë kërkesë për t'u pajisur me licencë, sipas parashikimeve të nenit 16 të këtij ligji, të vënë në dispozicion nga Agjencia;

b) vlerëson plotësimin e kushteve në lidhje me mjediset, pajisjet dhe personelin për marrjen e licencës;

c) harton listën dhe relacionin përkatës në lidhje me subjektet kërkuese, si dhe përgatit propozimin për dhënien ose refuzimin e licencës;

ç) në rast të konstatimit të shkeljeve, sipas përcaktimeve të këtij ligji, i propozon ministrit përgjegjës për shëndetësinë marrjen e masës administrative të pezullimit apo shfuqizimit të licencës.

7. Funksionet e asistencës dhe të mbështetjes logjistike të Komisionit të Licencave realizohen nga Agjencia përmes punonjësve të caktuar nga drejtori i përgjithshëm, që shërbejnë si sekretariat teknik për mbledhjet e Komisionit.

8. Organizimi i punës dhe i veprimtarisë së Komisionit bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë. Anëtarët e Komisionit ushtrojnë veprimtarinë e tyre kundrejt shpërblimit. Masa e shpërblimit për kryetarin dhe anëtarët e Komisionit përcaktohet sipas vendimit të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njësive të qeverisjes qendrore.

Neni 12

Njësitë e monitorimit të kultivimit, prodhimit dhe tregtimit të *cannabis*-it për qëllim mjekësor dhe industrial

1. Në Agjenci ngrihen dhe funksionojnë njësia e specializuar e mbikëqyrjes, kontrollit dhe inspektimit të kultivimit, prodhimit dhe qarkullimit të *cannabis*-it për qëllime industriale dhe njësia për mbikëqyrjen, kontrollin dhe inspektimin e kultivimit, prodhimit dhe qarkullimit të *cannabis*-it për qëllime mjekësore.

2. Njësitë drejojnë dhe koordinojnë veprimtarinë mbikëqyrëse, kontrolluese dhe inspektuese në bashkëpunim me strukturat e ministrisë përgjegjëse për bujqësinë për *cannabis*-in për qëllime industriale dhe ministritë përgjegjëse për shëndetësinë dhe për rendin, për *cannabis*-in për qëllime mjekësore.

3. Njësia për monitorimin e *cannabis*-it për qëllime industriale dhe strukturat e ministrisë përgjegjëse për bujqësinë hartojnë raportin mbi tokat që plotësojnë standardet për kultivimin e *cannabis*-it për qëllime industriale. Raporti i përbashkët i paraqitet ministrit përgjegjës për bujqësinë. Këshilli i Ministrave, brenda datës 30 nëntor të çdo viti kalendarik, miraton zonat kadastrale në të cilat, duke filluar nga data 1 janar e vitit pasardhës, lejohet kultivimi i *cannabis*-it për qëllim industrial.

4. Njësia e monitorimit të *cannabis*-it mjekësor i propozon ministrit përgjegjës për shëndetësinë raportin mbi tokat e kërkuara nga subjektet e licencuara, që plotësojnë standardet për kultivimin e *cannabis*-it për qëllime mjekësore, për miratim në Këshillin e Ministrave.



5. Njësitë monitorojnë procesin për të garantuar kultivimin vetëm të farërave dhe fidanëve të regjistruar në institucionin përgjegjës për regjistrimin e farërave dhe fidanëve, si dhe importin vetëm nga subjektet e pajisura me licencë dhe autorizim importi.

6. Njësia monitoron procesin e importimit të farërave dhe fidanëve që janë varietete të kultivimit të *cannabis*-it për qëllim mjekësor dhe industrial, të përfshira në Katalogun e Përbashkët Evropian të Varieteteve të Bimëve në Agrokulturë, si dhe procesin e riprodhimit të tyre.

Neni 13

Regjistri Kombëtar i aktivitetit të licencuar dhe të lejuar të bimës së *cannabis*-it

1. Të gjitha subjektet e licencuara dhe të lejuara në kuptim të këtij ligji regjistrohen në Regjistrin Kombëtar të subjekteve të licencuara dhe të lejuara.

2. Regjistri ngrihet në formën e bazës së të dhënave shtetërore, administrohet nga Agjencia dhe përmban të gjithë informacionin për kërkesën për licencim, vendimmarrjen për licencimin, kërkesën për autorizim, vendimmarrjen për autorizimin, kërkesën për leje, vendimmarrjen për lejen, gjurmimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin, masat administrative lidhur me të gjitha fazat e kultivimit të *cannabis*-it, duke filluar nga momenti i dhënies së licencës, lejes dhe autorizimit deri te revokimi i tyre, dhe sekuestrimi apo asgjësimi i bimëve apo nënprodukteve të saj, sipas parashikimeve të këtij ligji.

3. Në regjistër regjistrohen:

a) subjektet e licencuara e të lejuara për kultivimin e *cannabis*-it dhe të autorizuar për importimin e farërave e të fidanëve;

b) të dhëna për licencat, lejet për kultivimin e *cannabis*-it dhe autorizimet për importimin e farërave dhe fidanëve, si dhe të pezullimit apo shfuqizimit të tyre;

c) llojet e farërave dhe fidanëve, të cilët kultivohen nga subjektet sipas listës evropiane të farërave për *cannabis* për qëllime mjekësore dhe industriale;

ç) sasia e importuar, sasia e prodhuar, blerësi i lëndës së parë, produktet plehëruese të përdorura;

d) të dhënat në autorizimin e eksportit të nënprodukteve apo produkteve përfundimtare të

cannabis-it për qëllime industriale dhe mjekësore sipas parashikimeve të këtij ligji;

dh) lloji dhe sasia e bimës së *cannabis*-it, nënprodukteve apo produkteve përfundimtare të asgjësuar. Në rastin e *cannabis*-it industrial këto të dhëna regjistrohen sipas vetëdeklarimit të subjektit;

e) vendosja e shenjave unike dhe ndjekja e të gjitha fazave të sigurimit të farërave dhe fidanëve, kultivimi, prodhimi, tregtimi, furnizimi, transporti që i shërben identifikimit të bimës së *cannabis*-it, nënprodukteve dhe produktit përfundimtar. Shenjat unike në rastin e *cannabis*-it industrial nuk vendosen për tregtimin të përdoruesi fundor për eksport;

ë) masat administrative të marra ndaj subjekteve kultivuese.

4. Regjistri ndërvepron me bazat e tjera të të dhënave, të cilat i shërbejnë procesit të dhënies së licencave, lejeve dhe autorizimeve, si dhe mbikëqyrjes së procesit të kultivimit të *cannabis*-it për qëllime mjekësore dhe për qëllime industriale.

5. Në këtë regjistër kanë akses dhe strukturat përkatëse të ministrive përgjegjëse për shëndetësinë, për financat, rendin e sigurinë publike dhe bujqësinë.

6. Përcaktimi në mënyrë të hollësishme i të dhënave parësore dhe dytësore, përcaktimi i bazave konkrete të të dhënave me të cilat ndërvepron ky regjistër, niveli i aksesit të tij nga subjektet e interesuara apo publiku, përcaktimi i të dhënave që do të jenë publike, si dhe mënyra e regjistrimit dhe ruajtjes së të dhënave dhe dokumenteve që përmban regjistri përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e përbashkët të ministrit përgjegjës për shëndetësinë, ministrit përgjegjës për bujqësinë dhe ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

KREU III

PROCEDURA E PAJISJES ME LICENCË PËR USHTRIMIN E AKTIVITETEVE TË LIDHURA ME PRODHIMIN E *CANNABIS*-IT PËR QËLLIME MJEKËSORE

Neni 14

Licenca për ushtrim aktiviteti

1. Licenca për prodhimin e *cannabis*-it për qëllime mjekësore mund të përmbajë veprimtaritë e mëposhtme:

a) kultivimin, prodhimin e bimës së *cannabis*-it për qëllime mjekësore;



b) transportimin e farërave, bimëve dhe produkteve e nënprodukteve të *cannabis*-it për qëllime mjekësore në territorin e Republikës së Shqipërisë;

c) eksportin e bimëve, produkteve dhe nënprodukteve të *cannabis*-it për qëllime mjekësore.

2. Licenca jepet për një ose disa veprimtari, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij neni, për një periudhë 15-vjeçare, me të drejtë rinovimi me kërkesë, për secilin nga aktivitetet dhe bazuar në procedurën përzgjedhëse të organizuar nga Agjencia. Format i licencës për ushtrimin e aktiviteteve të lidhura me prodhimin e *cannabis*-it për qëllime mjekësore miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

3. Licenca i jepet vetëm subjektit që plotëson kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë ligj, si dhe vetëm për njësitë dhe aktivitetin e kërkuar e të përcaktuar në planzhvillimin e saj, duke përcaktuar koordinatat e vendndodhjes së njësive dhe marrëdhënien e subjektit me tokën.

4. Licenca jepet vetëm në emër të subjektit dhe është e patransferueshme dhe e patjetërsueshme. Licenca ka si pjesë përbërëse të saj aktivitetet për të cilat subjekti licencohet, me plotësimin e kërkesave të përcaktuara në këtë ligj.

5. Nëse në licencë është përcaktuar se aktivitete të caktuara, të parashikuara në licencë, mund të kryhen tërësisht apo pjesërisht nga subjekte të tjera, këto subjekte do të verifikohen në lidhje me plotësimin e kushtit të pastërtisë së figurës, si dhe përcaktohen shprehimisht në licencë. Ndryshimet që lidhen me tjetërsimin e pronësisë së këtyre subjekteve kërkojnë miratimin paraprak me shkrim të Komisionit të Licencimit. Komisioni jep ose refuzon miratimin paraprak, brenda 3 muajve nga paraqitja e plotë e kërkesës, mbështetur në dokumentacionin e përcaktuar në lidhje me verifikimin e pastërtisë së figurës.

6. Licenca përcakton një ose disa njësi për të cilat subjekti ka plotësuar kriteret. Nëse subjekti licencohet për më shumë se një njësi, ato duhet të jenë kufitare me njëra-tjetrën dhe, në çdo rast, jo më shumë se 4 njësi në të njëjtën licencë.

7. Licenca për aktivitetin e kultivimit jepet vetëm në sipërfaqe të hapura, të mbuluara ose sera. Sipërfaqja e njësive të licencës të aktivitetit për kultivim të *cannabis*-it për qëllime mjekësore nuk mund të jetë më e vogël se 5 hektarë dhe jo më e madhe se 10 hektarë.

8. Sipërfaqja totale e lejuar për kultivimin e bimës së *cannabis*-it për qëllime mjekësore nuk mund të jetë më e madhe se 200 hektarë në rang kombëtar.

9. Kërkuesi, për t'u pajisur me licencë, paguan në momentin e paraqitjes së kërkesës një tarifë në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë, e cila është e pakthyeshme. Procedura e pagimit të tarifës dhe mënyra e përdorimit të kësaj tarife përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për financat dhe ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

10. Kushtet e dhënies së licencës, të përcaktuara në pikën 2, të nenit 15, duhet të respektohen nga subjekti i licencuar gjatë të gjithë kohëzgjatjes së vlefshmërisë së saj. Çdo 3 vjet kushtet e licencës riveleshohen nga Agjencia, e cila, nëse konstaton mospërmbushjen e kushteve dhe kriterëve, propozon, sipas rastit, pezullimin ose shfuqizimin e licencës apo i kërkon subjektit plotësimin e kushteve brenda një afati 30-ditor.

11. Jo më vonë se 6 muaj përpara përfundimit të afatit të vlefshmërisë së licencës, subjekti mund të kërkojë rinovimin e saj kur provon se plotëson kushtet e pajisjes me licencë sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Neni 15

Kushtet për pajisjen me licencë

1. Çdo person juridik, që kërkon të pajiset me licencë, duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme për çdo aktivitet të kërkuar për licencim:

a) të ketë eksperiencë 3-vjeçare në të paktën 3 nga aktivitetet kryesore, si: prodhimi, kultivimi dhe qarkullimi i bimës së *cannabis*-it për qëllime mjekësore;

b) subjekti ose një aksionar i tij, i cili zotëron 51% të aksioneve të shoqërisë, duhet:

i. të jetë ushtrues i veprimtarisë së prodhimit të nënprodukteve të bimës së *cannabis*-it në një nga vendet e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim për të paktën 5 vjet;

ii. të jetë zotërues i praktikave të mira të prodhimit, të lëshuar nga Agjencia Evropiane e Barnave ose Agjencia Amerikane për Ushqimin dhe Barnat për të paktën 3 vjet;

iii. të ketë kapital të shoqërisë jo më të vogël se 100 000 000 (njëqind milionë) lekë;

iv. të ketë treguar performancë financiare pozitive në vitin e fundit financiar;



v. të këtë kapacitete administrative, organizative dhe besueshmërinë e duhur për t'u angazhuar me sukses në aktivitetet kryesore të kërkuara për licencim;

vi. të mos jetë i përfshirë në listat e personave të regjistruar ose të shpallur si financues të terrorizmit.

2. Personi juridik, që paraqet kërkesë për licencë për prodhimin e *cannabis*-it mjekësor, duhet ndër të tjera:

a) të përcaktojë në mënyrë taksative aktivitetin apo aktivitetet për të cilat kërkon të licencohet;

b) të paraqesë njësitë në të cilat do të zhvillojë aktivitetin me koordinata, si dhe marrëdhënien juridike me tokën;

c) të paraqesë planin e zhvillimit të biznesit, duke identifikuar modelin e kultivimit dhe qëllimin e kultivimit, si dhe sipërfaqen minimale e maksimale të njësisë së zhvillimit;

ç) të paraqesë planin e përpunimit të mjediseve për tharjen, prerjen dhe magazinimin, të pajisura në përputhje me kapacitetin prodhues, të parashikuara paraprakisht në planin e zhvillimit të prodhimit;

d) të paraqesë planin e sigurisë për sipërfaqen për kultivim dhe përpunim, duke përcaktuar elementet e mbrojtjes, rrethimit, sigurisë me telekamera dhe sigurimit fizik për 24 orë, elementet penguese përpara hyrjes dhe tel me gjemba mbi gardhin, sipas standardeve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave;

dh) të paraqesë vetëdeklarim për punësimin për të paktën 10 persona për çdo njësi, 2 prej të cilëve duhet të jenë punonjës të kualifikuar në fushën e farmacistë dhe agroinxhinierisë, me përvojë pune jo më pak se 3 vjet në fushën përkatëse;

e) të paraqesë vetëdeklarim për gatishmërinë për të lidhur marrëveshje me strukturën përgjegjëse të ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike, për të garantuar aksesin për inspektim ndaj shoqërisë private të sigurisë fizike që mbikëqyr mjediset e kultivimit të bimës së *cannabis*-it dhe nënprodukteve të saj, si dhe lëvizjes së automjeteve të dedikuara të tregtimit të lëndëve të para dhe produkteve, sipas rregullave dhe tarifave të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave;

ë) të paraqesë vetëdeklarim për fillimin e ushtrimit të veprimtarive të përshkruara në licencë brenda 12 muajve nga miratimi i saj;

f) të paraqesë vetëdeklarim se pas vitit të tretë do të paguajë një tarifë vjetore të barabartë me 1,5% të

qarkullimit vjetor, por, në çdo rast, jo më pak se 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë;

g) të paraqesë garanci bankare në masën 10% të vlerës së investimit;

gj) të paraqesë vetëdeklarim se do të plotësojë të gjitha kërkesat për gjurmueshmërinë sipas përcaktimeve të këtij ligji;

h) të paraqesë vetëdeklarim për proceset që kryhen nga subjekte të treta dhe identifikimin e tyre me të dhëna të sakta me qëllim vlerësimin dhe verifikimin e tyre;

i) të paraqesë vetëdeklarim për disponibilitetin e pagesave të tarifave të sistemit të gjurmimit.

Neni 16

Paraqitja e kërkesës dhe dokumentacioni i nevojshëm

Kërkesa për pajisje me licencë paraqitet pranë Agjencisë, së bashku me dokumentacionin dhe të dhënat e mëposhtme:

a) certifikatën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit;

b) ekstraktin historik të subjektit juridik dhe, sipas rastit, edhe aktin e themelimit e statutin e shoqërisë dhe listën e pronarëve përfitues, nëse ka;

c) të dhënat e përfaqësuesit ligjor apo të personit të autorizuar për të ndjekur procedurën e licencimit;

ç) vërtetime të lëshuara nga organet kompetente, si:

i. certifikata e sigurisë së subjektit, e lëshuar nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar për shtetasit shqiptarë, dhe certifikata e njësuar me të për shtetasit e huaj, e lëshuar nga autoritetet kompetente të vendit ku ata janë rezidentë;

ii. vërtetimi i lëshuar nga organi i prokurorisë që provon se subjekti, administratori, anëtarët e organeve drejtuese, ortakët apo aksionarët nuk janë në ndjekje penale;

iii. vërtetimi i lëshuar nga organi gjyqësor që provon se subjekti, administratori, anëtarët e organeve drejtuese, ortakët apo aksionarët nuk janë në gjykim për ndonjë vepër penale;

iv. certifikata e gjendjes gjyqësore që provon se subjekti, administratori, anëtarët e organeve drejtuese, ortakët apo aksionarët nuk janë të dënuar penalisht me vendim gjyqësor të formës së prerë;

v. vërtetimi nga organi përmbarues që provon se subjekti nuk është në proces ekzekutimi të detyrueshëm për detyrime pasurore të pashlyera;



vi. vërtetimi që provon se subjekti kërkues, ortakët apo aksionarët e subjektit kërkues nuk janë në procedurë falimentimi;

vii. pasqyrat financiare të subjektit kërkues, si dhe të aksionarëve të tij për 3 vjetët e fundit përpara paraqitjes së kërkesës;

viii. dokumente që vërtetojnë përvojën në aktivitetet përkatëse sipas kërkesave të përcaktuara në këtë ligj;

ix. vërtetimi nga organet tatimore për shlyerjen e detyrimeve tatimore si nga subjekti, ashtu edhe nga çdo subjekt juridik në rast bashkimi shoqërisht;

x. vërtetimi mbi disponimin e personelit të kualifikuar në ushtrimin e veprimtarisë sipas kërkesave të këtij ligji;

d) rregulloren përkatëse për rregullat dhe mënyrën e funksionimit të aktivitetit apo aktiviteteve për të cilat kërkon të licencohet;

dh) vetëdeklarimin për lidhjen e marrëveshjes paraprake për ruajtjen dhe sigurinë fizike sipas dispozitave të këtij ligji;

e) vetëdeklarimin për pagesën e garancisë bankare sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Neni 17

Njoftimi për konkurrimin për pajisje me licencë

1. Agjencia shpall njoftimin për konkurrim për pajisjen me licencë, për qëllime mjekësore, për të gjitha aktivitetet e saj, të licencuara sipas përcaktimeve të këtij ligji.

2. Njoftimi përmban:

a) listën e dokumentacionit të nevojshëm;

b) vendin dhe afatin e paraqitjes së kërkesës dhe dokumentacionit;

c) gjuhën dhe mënyrën e paraqitjes së dokumenteve;

ç) vendin, datën dhe orën e shqyrtimit të dokumentacionit.

Neni 18

Procedura e përzgjedhjes së subjektit fitues

1. Përzgjedhja e subjektit bëhet sipas një procedure konkurrimi të organizuar nga Agjencia, në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë ligj, pas marrjes së vlerësimit nga Komisioni i Licencave.

2. Anëtarët e Komisionit të Licencave vetëdeklarojnë nën përgjegjësinë tyre se pjesëmarrja

në këtë komision nuk përbën shkak për lindjen e një konflikti interesi me subjektet pjesëmarrëse në konkurrim. Në rast mosdeklarimi zbatohen masat e parashikuara në legjislacionin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike.

3. Komisioni i Licencave, pas verifikimit të dokumentacionit, pas vlerësimit të përmbushjes së kushteve dhe kriterëve të parashikuara nga ky ligj, harton një listë përfundimtare duke renditur pjesëmarrësit në konkurrim sipas pikëve të marra në përputhje me skemën e pikëzimit të miratuar nga Komisioni. Kandidati i renditur i pari në listë konsiderohet fitues.

4. Komisioni rendit pjesëmarrësit në konkurrim sipas vlerësimit të eksperiencës apo përvojës në ushtrimin e veprimtarisë dhe përvojës profesionale, duke iu referuar:

a) së pari, rezultateve të vlerësimit të përvojës në aktivitetet kryesore për të cilat jepet licenca, sipas parashikimeve të shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 15;

b) së dyti, në rastet e rezultateve të njëjta të vlerësimit të përvojës, viteve të eksperiencës apo përvojës profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 15.

5. Komisioni harton, miraton dhe publikon rregulla më të hollësishme, të cilat përcaktojnë:

a) kriteret për vlerësimin e përvojës në ushtrimin e aktiviteteve kryesore për të cilat jepet licenca ndërmjet pjesëmarrësve në konkurrim me pikë të barabarta vlerësimi;

b) kriteret për vlerësimin e përvojës profesionale që kërkohet;

c) procedurën që ndiqet në rastin e pikëve të barabarta.

6. Subjektet e listuara sipas pikës 3 kanë të drejtë të paraqesin ankim pranë ministrit përgjegjës për shëndetësinë, brenda 10 ditëve nga shpallja e njoftimit. Urdhri i ministrit mund të ankimohet në gjykatë sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

7. Me përfundimin e afatit për paraqitjen e ankesave dhe shqyrtimit të tyre dhe pasi kërkuesi i shpallur fitues të ketë përmbushur, brenda 30 ditëve, plotësimin e kriterit të lidhur me fondin e garancisë, Agjencia paraqet propozimin për dhënien e licencës pranë ministrit përgjegjës për shëndetësinë.



Neni 19

Miratimi i licencës

1. Ministri përgjegjës për shëndetësinë, me marrjen e propozimit për subjektin fitues sipas parashikimeve të nenit 18 të këtij ligji, brenda 3 muajve miraton licencën.

2. Urdhri për dhënien e licencës përcakton emrin e subjektit, zhvillimin e aktivitetit, afatin, sipërfaqen e shprehur në koordinata, një përshkrim të aktivitetit të licencuar në kuadër të kësaj licence, si dhe aktivitetet apo proceset që lejohen të kryhen nga palë të treta për llogari të mbajtësit të licencës. Urdhri i ministrit publikohet në Regjistrin Kombëtar të subjekteve të licencuara.

3. Nëse ministri nuk shprehet brenda 90 ditëve nga paraqitja e propozimit nga Agjencia, atëherë kërkesa konsiderohet e refuzuar.

4. Subjekti konsiderohet si mbajtës i licencës për ushtrimin e aktivitetit apo aktiviteteve, në kuptim të këtij ligji, në datën e urdhrit të ministrit për pajisjen me licencë.

Neni 20

Ndryshimi i të dhënave të licencës

1. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë, mbajtësi i licencës është i detyruar të njoftojë Agjencinë për të gjitha ndryshimet dhe devijimet nga masat e planifikuara më herët në planin e zhvillimit të biznesit, ndryshimet në dokumentacionin e paraqitur në momentin e paraqitjes së kërkesës për pajisje me licencë dhe ndryshimin e të dhënave që kanë të bëjnë me ndryshimin e subjekteve të treta apo përfundimin e marrëveshjes në lidhje me aktivitetet që do të ushtrohen pjesërisht apo tërësisht nga subjektet e treta.

2. Subjekti i licencuar i drejtohet Agjencisë me një informacion me shkrim, brenda 10 ditëve pune nga momenti që ka ndodhur ndryshimi, duke përshkruar çdo fakt e rrethanë që ka sjellë ndryshime apo devijime nga planifikimi.

3. Agjencia jep ose refuzon miratimin për këto ndryshime brenda 1 muaji nga paraqitja e plotë e informacionit, mbështetur në dokumentacionin e përcaktuar me akt nënligjor nga Agjencia dhe i propozon masa konkrete ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

4. Ministri përgjegjës për shëndetësinë, me marrjen e propozimit të Agjencisë, nëse konstaton

se ndryshimet lidhen me aktivitetet e përcaktuara në licencë, miraton ndryshimet e licencës, të cilat publikohen në të njëjtën mënyrë si publikimi i licencës.

Neni 21

Pezullimi dhe shfuqizimi i licencës

1. Ministri përgjegjës për shëndetësinë mund të pezullojë licencën nëse subjekti:

a) nuk zbaton legjislacionin në fuqi dhe aktet nënligjore të nxjerra për ushtrimin e aktiviteteve për të cilat është licencuar;

b) shkel kushtet e licencës;

c) nuk paraqitet brenda afatit të caktuar për ndryshimin e të dhënave të licencës.

2. Ministri përgjegjës për shëndetësinë vendos për shfuqizimin e licencës nëse subjekti:

a) shkel në mënyrë të përsëritur kushtet e licencës;

b) shkel në mënyrë të përsëritur legjislacionin në fuqi për ushtrimin e aktiviteteve për të cilat është licencuar;

c) kërkon shfuqizimin e licencës;

ç) nuk fillon zhvillimin e aktivitetit brenda një afati prej 12 muajsh nga miratimi i licencës;

d) e ka marrë licencën nëpërmjet mashtrimit;

dh) deklarohet i falimentuar dhe nuk është i aftë të kryejë detyrimet sipas kushteve të kësaj licence;

e) me mbarimin e personit juridik, mbajtës i licencës.

3. Verifikimi dhe konstatimi i shkeljeve, të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, bëhet nga Komisioni i Licencave, pasi ka dëgjuar edhe shpjegimet e subjektit, mbajtës të licencës.

4. Ministri përgjegjës për shëndetësinë, me propozimin e Komisionit të Licencave, vendos për pezullimin ose shfuqizimin e licencës.

5. Procedura e paraqitjes, afatet dhe shqyrtimi i propozimit për pezullimin apo shfuqizimin e licencës miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

6. Vendimi i pezullimit apo shfuqizimit të licencës merret pavarësisht nga sanksionet administrative e penale që mund të zbatohen dhe publikohet në të njëjtën mënyrë si publikimi i licencës.



KREU IV

PAJISJA ME LEJE PËR USHTRIMIN E
AKTIVITETEVE TË LIDHURA ME
PRODHIMIN E *CANNABIS*-IT INDUSTRIAL

Neni 22

Leja për ushtrimin e aktivitetit

1. Leja për ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të *cannabis*-it për qëllime industriale, këtu e në vijim “leja”, lejon aktivitetin e importit të farës ose fidanit, ose riprodhimit të tyre për qëllime të përdorimit si fara/fidanë, kultivimit, prodhimit dhe përpunimit, transportit, si dhe eksportit të nënprodukteve dhe produkteve përfundimtare të *cannabis*-it për qëllime industriale.

2. Leja jepet për një afat 5-vjeçar, me të drejtë rinovimi, për sipërfaqe jo më të vogla se 1 hektar.

3. Format i lejes dhe kriteret për aktivitetet e përfshira në të miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për bujqësinë.

4. Leja miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për bujqësinë, bazuar në procedurat përzgjedhëse të organizuara nga struktura përgjegjëse në ministrinë përgjegjëse për bujqësinë dhe publikohet në regjistrin përkatës.

5. Aktivitetet e përfshira në këtë leje nuk mund të transferohen te të tretët, me përjashtim të atyre të lejuara në përshkrimin e lejes.

6. Kopje e çdo lejeje të miratuar dhe praktikës, në bazë të së cilës është ndjekur procedura e shqyrtimit dhe miratimit të lejes, dorëzohet pranë Agjencisë, brenda 5 ditëve nga nxjerrja e urdhrit të ministrit për miratimin e lejes.

Neni 23

Kushtet për pajisjen me leje

1. Kërkesa për pajisjen me leje prodhimi paraqitet në ministrinë përgjegjëse për bujqësinë dhe shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) dokumentin e regjistrimit të fermerit, personit fizik ose juridik;

b) listën e personelit të punësuar ose të nënkontraktuar për të drejtuar procesin e kultivimit, nga i cili jo më pak se 1 agronom, shoqëruar me:

i. vërtetimin e lëshuar nga organi i prokurorisë që provon se subjekti nuk është në ndjekje penale;

ii. vërtetimin e lëshuar nga organi gjyqësor që provon se subjekti nuk është në gjykim për ndonjë vepër penale;

iii. certifikatën e gjendjes gjyqësore që provon se subjekti nuk është i dënues penalisht me vendim gjyqësor të formës së prerë;

iv. deklaratën për dhënien e miratimit, me qëllim kryerjen e kontrollit nga autoritetet kompetente të pastërtisë së figurës së punonjësve;

c) vetëdeklarimin për burimin e financimit të shpenzimeve;

ç) vetëdeklarimin që nuk ka detyrime tatimore ndaj administratës tatimore dhe njërive vendore;

d) vetëdeklarimin për lidhjen e marrëveshjes paraprake për ruajtjen dhe sigurinë fizike, sipas rregullave dhe tarifave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave;

dh) marrëveshjen paraprake të shitjes për subjektin e licencuar për përpunimin e lëndës së parë, i cili do ta blejë atë;

e) dokumentacionin e pronësisë, kopje kartelesh dhe hartë treguese të regjistrimit të tokës ose kontratë qiraje nëse toka nuk është në pronësi të subjektit kërkuar, me vendndodhje në zonat kadastrale, të miratuara për kultivim. Nëse toka nuk është e pajisur me dokument përfundimtar pronësie, paraqitet akti i marrjes së tokës në pronësi dhe planrilevimi.

ë) vetëdeklarimin për pagesat e tarifave të sistemit të gjurmimit.

2. Pas verifikimit të dokumentacionit nga struktura përgjegjëse në ministrinë përgjegjëse për bujqësinë, një kopje e praktikës i përcillet ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike, e cila brenda 10 ditëve jep vlerësimin për miratimin ose refuzimin e kërkesës.

3. Struktura përgjegjëse në ministrinë përgjegjëse për bujqësinë, pas marrjes së vlerësimit nga ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë, brenda 10 ditëve, paraqet raport për ministrin përgjegjës për bujqësinë për pajisjen me leje ose refuzimin e kërkesës.

4. Ministri përgjegjës për bujqësinë, me marrjen e raportit të njësisë, sipas parashikimit të pikës 3 të këtij neni, miraton lejen. Nëse ministri nuk shprehet brenda 30 ditëve nga paraqitja e raportit, kërkesa konsiderohet e refuzuar.

5. Subjekti konsiderohet si mbajtës i lejes, në kuptim të këtij ligji, në datën e urdhrit të ministrit për pajisjen me leje.



6. Leja e prodhimit shfuqizohet nëse gjatë ushtrimit të veprimtarisë konstatohet:

a) kryerja e aktivitetit në kundërshtim me kriteret e ligjit;

b) kryerja e aktivitetit në kundërshtim me kushtet e lejes;

c) mospagesa e tarifave për sistemin e gjurmimit dhe shenjimit;

ç) shkelja e dispozitave të tjera ligjore që lidhen me ushtrimin e veprimtarisë së subjektit të pajisur me leje.

7. Gjatë fazës së verifikimeve të kryera, sipas parashikimeve të pikës 6 të këtij neni, ministri mund të vendosë pezullimin e lejes së kultivimit deri në marrjen e vendimit përfundimtar.

KREU V ZHVILLIMI I AKTIVITETEVE TË LICENCUARA APO TË LEJUARA

Neni 24 Njësia e prodhimit

1. Aktivitetet e përcaktuara në licencë ose leje, sipas parashikimeve të këtij ligji, zhvillohen vetëm në mjediset e njësive të prodhimit me akses të kufizuar dhe të monitoruar.

2. Njësia e prodhimit është sipërfaqja e tokës nga 5 deri në 10 hektarë, e kufizuar, në të cilën përfshihen edhe magazina dhe ambientet e tjera të dedikuara vetëm me proceset e lidhura me kultivimin e bimës së *cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve për qëllime mjekësore dhe sipërfaqja jo më e vogël se 1 hektar, në të cilën përfshihen edhe magazina dhe ambientet e tjera të dedikuara vetëm me proceset e lidhura me kultivimin e bimës së *cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve të bimës së *cannabis*-it për qëllime industriale.

3. Numri, sipërfaqja dhe vendndodhja e njësive të prodhimit përcaktohen në mënyrë të hollësishme në licencë ose leje.

4. Licenca lejon prodhimin deri në 4 njësi prodhimi kufitare. Për njësitë jokufitare nevojitet pajisja me licencë më vete.

5. Kapaciteti i njësive për përpunim dhe magazinim duhet t'i përgjigjet kapacitetit të saj për kultivim.

Neni 25

Importi i farës dhe fidanëve të bimës së *cannabis*-it

Importi i farës dhe fidanit të bimës së *cannabis*-it kryhet nga subjekti i pajisur me licencë ose leje pas autorizimit të dhënë nga Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve, sipas parashikimeve të ligjit nr. 10 416, datë 7.4.2011, "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor".

Neni 26

Mbjellja e bimës

1. Subjekti i pajisur me licencë apo leje për aktivitetin e mbjelljes lejohet të mbjellë vetëm fara dhe fidanë të regjistruar në institucionin përgjegjës për regjistrimin e farërave dhe fidanëve.

2. Subjekti i pajisur me licencë për mbjelljen e *cannabis*-it për qëllime mjekësore apo leje për kultivimin e *cannabis*-it për qëllime industriale, jo më vonë se 10 ditë përpara fillimit të mbjelljes së farës së *cannabis*-it, është i detyruar të njoftojë Agjencinë apo njësinë rajonale të ministrisë përgjegjëse për bujqësinë, duke i kërkuar të jenë të pranishme në procesin e mbjelljes.

3. Pas mbikëqyrjes së procesit të mbjelljes, në prani të përfaqësuesit të subjektit, mbahet procesverbali përkatës, një kopje e të cilit depozitohet pranë Agjencisë.

4. Të dhënat për procesin e mbjelljes regjistrohen në regjistrin përkatës.

Neni 27

Mbikëqyrja e vjeljes së bimëve

1. Kultivuesi i bimës së *cannabis*-it, jo më vonë se 15 ditë para ditës së fillimit të vjeljes së bimës së *cannabis*-it, është i detyruar të njoftojë Agjencinë, duke i kërkuar që përfaqësuesi i kësaj agjencie të jetë i pranishëm në procesin e vjeljes. Agjencia njofton ministritë përgjegjëse sipas qëllimit të kultivimit të bimës së *cannabis*-it.

2. Pas mbikëqyrjes së procesit të vjeljes, në prani të përfaqësuesit të subjektit mbahet procesverbali përkatës, një kopje e të cilit depozitohet pranë Agjencisë.

3. Pas përfundimit të procesit të vjeljes së *cannabis*-it për qëllim mjekësor, Agjencia kryen kontrollin në sasi të korresponduarës së kryer dhe të materialit



të prodhuar, dhe regjistrohet në procesverbal numrin e fidanëve të mbledhur dhe sasinë në peshë të masës së lagësht.

4. Të dhënat për procesin e vjeljes regjistrohen në regjistrin përkatës.

Neni 28

Përpunimi dhe lënda e parë

1. Materiali i prodhuar nga bima e *cannabis*-it thahet, pastrohet, ndahet, paketohet dhe shenjohe.

2. Pas përfundimit të korjes, pjesa mbitokësore e grumbulluar e bimës së *cannabis*-it thahet në një hapësirë të rregulluar në mënyrë të posaçme.

3. Kultivuesi i *cannabis*-it mban një procesverbal të posaçëm në 3 kopje për sasinë e prodhuar, në prani të punonjësve të Agjencisë. Një kopje i dërgohet ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike, një kopje e mban subjekti kultivues, ndërsa një kopje e mban Agjencia.

4. Kultivuesi i *cannabis*-it dorëzon një raport pranë strukturës përgjegjëse të ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike dhe Agjencisë për përfundimin e procesit të prodhimit, kultivimit dhe masës së fituar të thatë, brenda 10 ditëve nga data e përfundimit të procesit.

5. Përpara se materiali i thatë të paketohet, Agjencia kryen kontrollin e cilësisë në laboratorë të certifikuar dhe të akredituar, sipas parashikimeve të legjislacionit përkatës për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit. Metoda për kontrollin e cilësisë, lidhur me përmbajtjen e komponentëve të kanabinoidit dhe tetrahidrokanabinolit, si dhe kontrollin fiziko-kimik dhe mikrobiologjik për mënyrën e paketimit, formën dhe sasinë, përcaktohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për bujqësinë.

6. Paketimi i bimës së thatë përmban të dhënat e mëposhtme:

- a) emrin dhe selinë e subjektit kultivues;
- b) ditën, muajin dhe vitin e korjes e të prodhimit;
- c) emrin e lëndës së parë;
- d) sasinë neto dhe bruto të masës së thatë;
- d) formën e bimës, nëse është gjethe, lule, bimë, e plotë apo e prerë;
- dh) datën e paketimit dhe afatin e skadencës;
- e) shenjen unike identifikuese.

Neni 29

Produktet dhe nënproduktet e prodhuara nga bima e *cannabis*-it mjekësor

1. Produktet dhe nënproduktet e destinuara për përdorim mjekësor, të prodhuara nga bima e *cannabis*-it nga prodhuesi i licencuar, i nënshtrohen të gjitha dispozitave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për barnat dhe shërbimin farmaceutik, legjislacionin për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope, dhe legjislacionin për produktet kozmetike përpara nxjerrjes së tyre në qarkullim.

2. Të gjitha nënproduktet dhe produktet e prodhuara në vend, sipas pikës 1, janë të destinuara vetëm për eksport, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Neni 30

Transporti

Posedimi, lëvizja, shoqërimi dhe transportimi i farërave, fidanëve, lëndës së parë, të bimës së *cannabis*-it mjekësor dhe nënprodukteve të saj nga një vend në një vend tjetër bëhen nga subjekti i licencuar për këtë veprimtari, pasi të njoftojë paraprakisht Agjencinë. Në çdo rast, transporti kryhet nëpërmjet shoqërimit nga një shoqëri e ruajtjes dhe sigurisë fizike sipas kontratës së lidhur me subjektin e licencuar.

Neni 31

Siguria

Ruajtja dhe siguria e njësisë, transportit dhe tregtimit bëhen nga subjekti që ka lidhur kontratën e ruajtjes dhe sigurisë së njësisë me subjektin e licencuar.

Neni 32

Eksporti i nënprodukteve të bimës së *cannabis*-it

1. Eksporti i nënprodukteve apo produkteve përfundimtare të bimës së *cannabis*-it kryhet nga subjekti i pajisur me licencë, sipas parashikimeve të këtij ligji.

2. Eksporti i nënprodukteve apo produkteve përfundimtare të *cannabis*-it për qëllime mjekësore bëhet sipas legjislacionit në fuqi për barnat dhe legjislacionit për barnat narkotike e lëndët psikotrope dhe për produktet kozmetike.



3. Eksporti i nënprodukteve apo produkteve përfundimtare të *cannabis*-it për qëllime industriale bëhet nga Agjencia, sipas parashikimeve të udhëzimit të përbashkët të ministrit përgjegjës për bujqësinë dhe ministrit përgjegjës për ekonominë.

4. Eksporti i nënprodukteve apo produkteve përfundimtare të bimës së *cannabis*-it duhet të kryhet me një autorizim të veçantë për eksportin, i cili përmban këto të dhëna:

a) emrin e produktit, emrin ndërkombëtar të pronarit, nëse ka, sasinë që do të eksportohet;

b) emrin dhe adresën e importuesit e të eksportuesit dhe duhet të specifikojë periudhën brenda së cilës duhet të kryhet importimi ose eksportimi;

c) nëse vendi i importuesit parashikon detyrimin për t'u pajisur me certifikatë importi apo dokument tjetër analog me këtë certifikatë, numrin dhe datën e certifikatës së importit dhe autoritetin që e ka lëshuar atë

5. Përpara lëshimit të autorizimit të eksportit, në vendet që parashikojnë detyrimin për t'u pajisur me certifikatë importi apo dokument tjetër analog, Agjencia duhet të kërkojë paraqitjen nga subjekti të një certifikate importi të lëshuar nga autoritetet kompetente të vendit apo të territorit importues.

KREU VI SHENJIMI DHE GJURMIMI

Neni 33 Gjurmueshmëria

1. Agjencia administron Regjistrin Kombëtar të subjekteve të lejuara e të licencuara dhe mbikëqyr vendosjen e shenjave unike për identifikimin dhe gjurmimin në të gjitha fazat e kultivimit, prodhimit, tregtimit, furnizimit, transportit të bimës së *cannabis*-it, nënprodukteve dhe produkteve përfundimtare deri te përdoruesi fundor sipas parashikimeve të këtij ligji.

2. Subjektet e licencuara dhe të lejuara, sipas kuptimit të këtij ligji, kanë detyrimin të hedhin të dhënat në këtë regjistrë.

3. Për qëllime kontrolli dhe inspektimi të aktiviteteve të licencuara dhe të lejuara në këtë regjistrë kanë akses:

- a) ministria përgjegjëse për shëndetësinë;
- b) ministria përgjegjëse për bujqësinë;
- c) ministria përgjegjëse për financat;

ç) ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë;

d) Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore;

dh) institucione apo subjekte të lejuara me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

Neni 34

Shenjimi dhe gjurmimi

1. Shenjimi bëhet nëpërmjet shenjës unike në formë kodi, pulle, etikete apo çdo lloj tjetër shenjimi dhe është i detyrueshëm në të gjitha fazat, përfshirë importimin, kultivimin, prodhimin, përpunimin, magazinimin, ruajtjen e bimës së *cannabis*-it mjekësor dhe industrial, nënprodukteve dhe produkteve përfundimtare të saj, eksportin dhe përdorimin e nënprodukteve apo produkteve përfundimtare të bimës së *cannabis*-it mjekësor dhe industrial me qëllim lehtësimin e gjurmueshmërisë.

2. Gjurmimi është një mënyrë identifikimi për përcaktimin e saktë të vendndodhjes së bimës së *cannabis*-it mjekësor dhe industrial, nënprodukteve dhe produkteve përfundimtare të saj në të gjitha fazat nga mbjellja deri te përdorimi i fundit, si dhe të poseduesit të saj në të gjitha fazat. Gjurmimi nuk aplikohet për *cannabis*-in industrial për tregtimin te përdoruesi fundor.

3. Të gjithë zotëruesit e një licence, sipas përcaktimeve të këtij ligji, janë të detyruar të shenjojnë bimën, farën, substancën, preparatin, produktin, që është objekt i veprimtarisë së tij, dhe të zbatojnë të gjithë legjislacionin lidhur me shenjimin dhe gjurmimin.

4. Kostoja e shenjimit dhe gjurmimit përballohet nga subjektet e licencuara dhe të lejuara sipas këtij ligji. Tarifat dhe procedurat e pagesës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për financat, ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe ministrit përgjegjës për bujqësinë.

5. Kërkesat për gjurmueshmërinë, si dhe rregullat për elementet, etiketën apo pullën unike të shenjimit apo forma të tjera të shenjimit, procedura dhe mënyra e shenjimit dhe gjurmimit, si dhe autoriteti apo pala e autorizuar për realizimin e shenjimit dhe gjurmueshmërisë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për shëndetësinë e të ministrit përgjegjës për bujqësinë.



KREU VII MBIKËQYRJA

Neni 35 Organet përgjegjëse

1. Për inspektimin e zbatimit të parashikimeve të këtij ligji, ngarkohen Agjencia, strukturat përgjegjëse për regjistrimin e farërave dhe fidanëve dhe shëndetin e bimëve, dhe Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, sipas detyrave të parashikuara në këtë ligj dhe në përputhje me kompetencat e tyre ligjore.

2. Agjencia koordinon procesin e mbikëqyrjes me institucionet e tjera.

Neni 36 Mbikëqyrja dhe kontrolli

1. Mbikëqyrja e zbatimit të parashikimeve të këtij ligji dhe rregullave të miratuara në bazë të tij, në lidhje me aktivitetet e licencuara, kryhet nga Agjencia nëpërmjet punonjësve të saj.

2. Përmbushja e detyrimeve në kuadër të ligjit të barnave mbikëqyret dhe monitorohet nga struktura përgjegjëse për inspektimin farmaceutik.

3. Përmbushja e detyrimeve për procesin e regjistrimit të farërave e të fidanëve dhe kontrollit të shëndetit të bimëve kryhet nga strukturat përgjegjëse të ministrisë përgjegjëse për bujqësinë.

4. Mbikëqyrja gjatë procesit të asgjësimit të bimës së *cannabis*-it dhe nënprodukteve të saj apo produkteve përfundimtare bëhet nga Agjencia në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse të ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike.

5. Rregulla më të hollësishme për mbikëqyrjen përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, bazuar në rregullat e përgjithshme të legjislacionit në fuqi për inspektimin.

Neni 37 Marja e mostrave dhe kampionëve

1. Marja e mostrave kryhet nëpërmjet Agjencisë në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për mbikëqyrjen, sipas këtij ligji.

2. Ministri përgjegjës për shëndetësinë dhe ministri përgjegjës për bujqësinë përcaktojnë me udhëzim të përbashkët mënyrën, sasinë e marrjes së

mostrave dhe laboratorin për kryerjen e analizave me metodat e akredituara për kontrollin e cilësisë, brenda ose jashtë vendit.

KREU VIII SEKUESTRIMI DHE ASGJËSIMI

Neni 38 Konfiskimi i bimës së *cannabis*-it për qëllime mjekësore, nënprodukteve të saj dhe produkteve përfundimtare

1. Bima e *cannabis*-it për qëllime mjekësore, nënproduktet e saj dhe produktet përfundimtare konfiskohen me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë, me propozimin e Agjencisë nëse konstatohet se:

a) kultivohen, përpunohen, qarkullojnë ose posedohen nga një subjekt i palicencuar;

b) nuk janë të shenjuara dhe të gjurmueshme sipas përcaktimeve të këtij ligji.

2. Bima e *cannabis*-it për qëllime mjekësore, nënproduktet e saj dhe produktet përfundimtare, të konfiskuara sipas këtij ligji, i nënshtrohen, për aq sa është e zbatueshme, rregullimit të administrimit të barnave të konfiskuara, sipas legjislacionit në fuqi për barnat dhe shërbimin farmaceutik.

3. Agjencia regjistron në regjister llojin dhe sasinë e bimës së *cannabis*-it të konfiskuar.

4. Në rastin e konfiskimit të bimës së *cannabis*-it, nënprodukteve të saj dhe produkteve përfundimtare, Agjencia dhe institucionet shtetërore mbikëqyrëse kanë detyrimin që të njoftojnë strukturat përgjegjëse për rendin dhe sigurinë, si dhe të zbatojnë sanksionet përkatëse për të gjitha ato veprime që vijnë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 39 Asgjësimi i bimëve të kultivuara

1. Bimët e *cannabis*-it mjekësor, pavarësisht qëllimit të përdorimit, nëse kanë mbirë vetvetiu, si dhe mbetjet e bimës së *cannabis*-it mjekësor në sipërfaqen e tokës, të përcaktuara në licencë apo leje, asgjësohen sipas mënyrës dhe parashikimeve të këtij ligji nga subjekti i licencuar apo i lejuar, në prani të përfaqësuesit të Agjencisë. Për kryerjen e këtij procesi mbahet procesverbali përkatës sipas legjislacionit në fuqi.



2. Nëse subjekti nuk përmbush detyrimin e pikës 1, asgjësimi kryhet nga Agjencia me shpenzimet e subjektit, ndaj të cilit merret masë administrative për mospërmbushjen e këtij detyrimi.

3. Subjekti i autorizuar për kultivimin e *cannabis*-it industrial kryen asgjësimin e bimëve që nuk përdoren për qëllime tregtimi ose të mbetjeve të bimëve dhe raporton në Agjenci për sasinë e bimëve të asgjësuar.

4. Agjencia mban regjistër të veçantë për llojin dhe sasinë e bimës së *cannabis*-it të asgjësuar.

5. Mënyra e hollësishme e asgjësimit të bimëve të mbira vetvetiu dhe mbetjeve të bimëve të korrura ose të asgjësuar, sipas pikave 1, 2 dhe 3 të këtij neni, përcaktohet me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për shëndetësinë, ministrit përgjegjës për bujqësinë dhe ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

KREU IX SANKSIONET

Neni 40

Kundërvajtjet administrative

1. Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

a) me gjobë nga 500 000 (pesëqind mijë) deri në masën 1 000 000 (një milion) lekë nëse subjekti i licencuar apo i lejuar:

i. përdor barna narkotike dhe lëndë psikotrope në kundërshtim me kushtet e përcaktuara me këtë ligj;

ii. reklamon në mënyrë direkte apo indirekte të gjitha veprimtaritë në lidhje me bimën e *cannabis*-it për qëllime mjekësore;

iii. kryen shitje në territorin e Republikës së Shqipërisë të bimës së *cannabis*-it mjekësor, nënprodukteve të saj apo produkteve përfundimtare;

iv. nuk zbaton masat e dhëna nga Agjencia në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së licencuar apo të lejuar;

v. pengon procesin e marrjes së mostrave sipas parashikimeve të nenit 37 të këtij ligji;

vi. tejkalon afatin e caktuar për grumbullimin e sasive të prodhuara të masës së fituar të thatë të *cannabis*-it për qëllime mjekësore;

vii. nuk përmbush detyrimet, në lidhje me njoftimin e ministrisë përgjegjëse për rendin dhe

sigurinë publike, të ministrisë përgjegjëse për bujqësinë dhe të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, për çdo gjendje që tregon dyshim se *cannabis*-i ose pjesë të bimëve të saj janë përdorur ose do të mund të përdoren për prodhimin e lëndëve narkotike dhe psikotrope;

viii. nuk përmbush detyrimet në lidhje me mbajtjen e regjistrit për sasinë e prodhuar dhe atë të blerë të *cannabis*-it për qëllime mjekësore dhe/ose industriale apo nuk dorëzon raportin brenda afateve ligjore tek autoritetet mbikëqyrëse;

b) me gjobë nga 1 000 000 (një milion) deri në masën 3 000 000 (tre milionë) lekë nëse subjekti i licencuar apo i lejuar:

i. nuk zbaton kushtet në lidhje me transportin e bimës së *cannabis*-it për qëllime mjekësore gjatë transportit apo kushtet për ruajtjen e paketimit origjinal;

ii. nuk respekton rregullat në lidhje me planin e përpunimit dhe zhvillimit të prodhimit;

iii. nuk respekton rregullat në lidhje me planin e sigurisë, përfshirë përcaktimin e elementeve të mbrojtjes, rrethimit, sigurisë me telekamera dhe sigurisë fizike;

iv. nuk respekton rregullat në lidhje me shenjimin apo gjurmimin.

c) me gjobë nga 3 000 000 (tre milionë) deri në masën 5 000 000 (pesë milionë) lekë nëse subjekti i licencuar apo i lejuar:

i. fsheh ose falsifikon dokumentet duke mbjellë dhe administruar sipërfaqe më të mëdha me *cannabis* mjekësor ose industrial ose kur regjistrimin e sipërfaqeve nuk e ka kryer brenda afatit të parashikuar;

ii. nuk deklaron sipërfaqet në të cilat kultivon *cannabis* për qëllime mjekësore dhe/ose *cannabis* për qëllime industriale;

iii. eksporton nënprodukte ose produkte përfundimtare në sasi të ndryshme nga ajo e deklaruar, sipas përcaktimeve të këtij ligji;

iv. raporton në mënyrë të rremë të dhënat, për efekt të plotësimit të regjistrave, e parashikuara në këtë ligj;

v. kryen procese për të cilat nuk është i licencuar, i lejuar apo i autorizuar;

vi. vazhdon aktivitetin edhe pas përfundimit të afatit të licencës apo lejes;

vii. pengon, shmang mbikëqyrjen apo verifikimin në lidhje me shenjimin dhe gjurmimin;



viii. kultivon, prodhon, përpunon, furnizon, tregton, mban, transporton bimë, fara, produkt me lëndë narkotike ose psikotrope të pashenjuar, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 34 për shenjimin dhe gjurmimin.

2. Krahës gjobës së parashikuar në pikën 1 të këtij neni, personit juridik mund t'i caktohet si sanksion edhe ndalimi i përkohshëm i kryerjes së veprimtarisë për një periudhë nga 6 muaj deri në 3 vjet.

3. Kundërvajtjet administrative, sipas parashikimeve të këtij ligji, konstatohen dhe sanksionohen nga Agjencia.

4. Në kushtet e konstatimit të shkeljeve të Kodit Penal, Agjencia raporton, në zbatim të parashikimeve të Kodit Penal, pranë autoriteteve përkatëse sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale.

5. Të ardhurat nga gjobat derdhen 100% në buxhetin e shtetit.

Neni 41 Ankimi

Ndaj masave administrative të marra nga Agjencia, si dhe ndaj çdo veprimi tjetër administrativ të kryer në kundërshtim me Kodin e Procedurave Administrative dhe me këtë ligj, subjektet mund të paraqesin ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KREU X DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 42 Dispozita kalimtare

1. Subjektet, të cilat në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji ushtrojnë aktivitetin e kultivimit dhe prodhimit të *cannabis*-it për qëllim industrial, sipas legjislacionit në fuqi për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope, brenda 8 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji kanë të drejtë të përshtatin aktivitetin e lejuar për t'u pajisur me leje, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

2. Ushtrimi i aktivitetit nga subjektet e përcaktuara në pikën 1, pa u pajisur me leje sipas parashikimeve të këtij ligji, pas kësaj periudhe konsiderohet i paligjshëm.

3. Agjencia Kombëtare e Kontrollit të *Cannabis*-it krijohet brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 43 Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 7, pika 3; 9, pika 2; 13, pika 6; 15, pika 2; 23, pika 1; 34, pikat 4 e 5, dhe 36, pika 5.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për shëndetësinë që brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 11, pika 8, dhe 14, pika 2.

3. Ngarkohet ministri përgjegjës për bujqësinë që brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të nenit 9, pika 3.

4. Ngarkohen ministrat sipas fushës së tyre të përgjegjësisë që brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të neneve 6, pika 4; 8, pika 8; 14, pika 9; 32, pika 3; 37, pika 2, dhe 39, pika 5.

Neni 44 Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, dispozitat e ligjit nr. 7975, datë 26.7.1995, "Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope", të ndryshuar, dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore, që bien ndesh me parashikimet e këtij ligji, shfuqizohen.

Neni 45 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 21.7.2023.

**LIGJ**
Nr. 69/2023**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME**
NË LIGJIN NR. 53/2019, “PËR
AKADEMINË E SHKENCËVE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 53/2019, “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë” bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 6, pika 3 riformulohet si më poshtë:

“3. Asambleja zgjedh edhe anëtarë të jashtëm ndër personat me shtetësi apo origjinë shqiptare me banim jashtë vendit, figura të shkencës e të kulturës, si dhe anëtarë nderi ndër figurat e shkencës e të kulturës që janë shtetas joshqiptarë me banim jashtë vendit, të cilët me punimet e tyre kanë ndikuar në ecurinë e mendimit e të zbatimit të shkencës në Shqipëri apo në promovimin e të vërtetave dhe të vlerave të origjinës, gjuhës e kulturës shqiptare.

Numri i anëtarëve të nderit është deri në 15. Personat me origjinë shqiptare, që janë anëtarë me të drejta të plota të një akademie pjesëtare të “*All European Academies*”, fitojnë drejtpërdrejt statusin e anëtarit të jashtëm të Akademisë së Shkencave, e cila formalizohet nga një mbledhje ceremoniale e Asamblesë.”.

Neni 2

Neni 10 riformulohet si më poshtë:

“Anëtarët e jashtëm dhe ata të nderit kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjet e Asamblesë pa të drejtë vote, si dhe në të gjitha aktivitetet e Akademisë. Me pëlqimin e tyre, ata aktivizohen dhe kontribuojnë në plotësimin e detyrave të Akademisë

dhe të anëtarëve të saj, të parashikuara në nenet 4 dhe 9, të këtij ligji.”.

Neni 3

Në nenin 11, pika 3 riformulohet si më poshtë:

“3. Kryetari i Akademisë së Shkencave dhe anëtarët e Kryesisë zgjidhen nga Asambleja me votim të fshehtë dhe të drejtpërdrejtë me shumicën absolute të votave të vlefshme të anëtarëve të Asamblesë.”.

Në nenin 11, pika 4 riformulohet si më poshtë:

“4. Mandati i Kryetarit dhe i zëvendëskryetarit është 4 vjet, ndërsa ai i sekretarit shkencor dhe i drejtuesve të seksioneve është 5 vjet.

Kryetari, zëvendëskryetari, sekretari shkencor dhe drejtuesit e seksioneve mund të rizgjidhen në të njëjtin funksion për dy mandate.”.

Pikat 9 dhe 10, të nenit 11 shfuqizohen.

Neni 4

Në nenin 14, pika 4, fjala “korrespondent” zëvendësohet me fjalën “i jashtëm”.

Neni 5

Në nenin 16, pika 2, shkronja “c” shfuqizohet.

Neni 6**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 21.7.2023.

DEKRET

Nr. 190, datë 14.8.2023

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, e nenit 93 të Kushtetutës; nenit 9, si dhe nenit 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,



DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të shtetasve të mëposhtëm:

1. Medon Bajram Berisha
2. Arda Okan Ramazan Kurtulan
3. Arbnor Naser Muja
4. Agan Besim Mjaki
5. Meritan Izijadin Shabani
6. Behar Fuat Ismaili
7. Lindon Bekim Ajeti
8. Arbër Ukë Hoxha

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

UDHËZIM
Nr. 121, datë 14.8.2023

**PËR PROCEDURAT E HARTIMIT TË
LISTAVE TË ZGJEDHËSVE PËR
ZGJEDHJET, PËR KRYETAR TË
BASHKISË KUKËS**

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 45, 46, 47, 48, 50, 51, 56, 57, 59 dhe 62, të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të dekretit nr. 186, datë 11.8.2023, të Presidentit të Republikës, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për kryetar të Bashkisë Kukës”,

UDHËZOJ:

1. Hartimin e listës së zgjedhësve nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile (RKGjC) i vitit 2010, brenda datës 16.8.2023. Në përbërje të listës së zgjedhësve janë të gjithë shtetasit me të drejtë vote, të lindur që nga data 24.9.2005, të cilët deri në datën e zhvillimit të zgjedhjeve për kryetar të Bashkisë Kukës, më 24.9.2023, mbushin 18 vjeç.

2. Miratimin dhe shpalljen e listës së zgjedhësve për zgjedhjet për kryetar të Bashkisë Kukës, në përputhje me nenin 48 të Kodit Zgjedhor, brenda datës 18.8.2023, nga kryetari i Bashkisë Kukës, i komanduar në detyrë.

3. Gjenerimin e listës së zgjedhësve në përputhje me procedurën e parashikuar në udhëzimin nr. 225, datë 11.5.2016, të ministrit të Punëve të Brendshme, “Për procedurat e pezullimit nga lista e zgjedhësve për shtetasit që vuajnë dënimin, parashikuar nga ligji nr. 138/2015, Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

4. Caktimin e zgjedhësve në listën e qendrës së votimit përkatëse, sipas kodit të vendbanimit. Renditjen e zgjedhësve brenda qendrës së votimit sipas rendit alfabetik të mbiemrit.

5. Grupimin e listës së zgjedhësve sipas zonave të qendrave të votimit, kufijtë e të cilave janë ato të zgjedhjeve të fundit. Kryetari i Bashkisë Kukës, i komanduar në detyrë, i cili ka marrë njoftimin nga nëpunësi i zyrës së gjendjes civile në Bashkinë Kukës/njësitë administrative nën juridiksionin e saj, se ka qendra votimi me më pak se 300 (treqind) zgjedhës, apo qendra votimi me më shumë se 1 000 (një mijë) zgjedhës, brenda 48 orëve vendos për bashkimin dhe/ose ndarjen e qendrave të votimit, sipas kërkesave të kriterit numerik dhe cakton adresën e qendrës së votimit.

6. Limiti i poshtëm për qendrën e votimit i referohet një numri prej 15 (pesëmbëdhjetë) zgjedhësish, në rastin e institucioneve të posaçme (burgjeve, vendeve të paraburgimit, si dhe spitaleve ose institucioneve të tjera shëndetësore, që pranojnë pacientë për më shumë se 3 ditë), të cilat përbëjnë zonë të veçantë qendre votimi.

7. Kryetari i Bashkisë Kukës, i emëruar në detyrë, vendos për rindarjen e qendrave të votimit me fraksion që kalojnë limitin numerik të përcaktuar në Kodin Zgjedhor, duke u nisur nga numri i përgjithshëm i zgjedhësve të qendrës së votimit bazë. Numri i përgjithshëm i një qendre votimi, me të gjithë fraksionet e saj ndahet në pjesë të barabarta, me jo më shumë se 1000 (një mijë) zgjedhës secila.

8. Kryetari i Bashkisë Kukës, i komanduar në detyrë, vendos për bashkimin e qendrave të votimit me më pak se 300 (treqind) zgjedhës, me një qendër më të afërt dhe me mundësi komunikimi rrugor. Numri i përgjithshëm i zgjedhësve në qendrat e



bashkuara të votimit duhet të jetë mbi 300 (treqind) zgjedhës.

Kryetari i Bashkisë Kukës i komanduar në detyrë, vendos ndarjen me fraksion të qendrës së votimit të krijuar, në rastet kur numri i përgjithshëm i zgjedhësve për qendrat që bashkohen rezulton të jetë më shumë se 1 000 (një mijë), sipas pikës 7 të këtij udhëzimi. Në rastet kur dy ose më shumë qendra votimi kanë më pak se 300 (treqind) zgjedhës, qendra/qendrat me numër më të vogël i bashkohen atyre me numër më të madh zgjedhësish.

9. Kryetari i Bashkisë Kukës, i komanduar në detyrë, u dërgon menjëherë për zbatim zyrës së gjendjes civile në Bashkinë Kukës/zyrave të gjendjes civile nën juridiksionin e saj, vendimet për ndarjen ose bashkimin e qendrave të votimit, si dhe vendimet për ndryshimin e adresave të qendrave të votimit nëse ka. Këto vendime i dërgon gjithashtu në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile në Ministrinë e Brendshme, si dhe për dijeni prefektut të qarkut Kukës.

10. Përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile në Bashkinë Kukës/njësitë administrative nën juridiksionin e saj kryen veprimet përkatëse në Regjistrin Kombëtar, brenda 24 orëve nga marrja e vendimit të kryetarit të komanduar në Bashkinë Kukës, për ndarjen e qendrave të votimit referuar kriterëve të parashikuara ligjore.

11. Nëpunësit e zyrave të gjendjes civile në Bashkinë Kukës/njësitë administrative nën juridiksionin e saj, përditësojnë informacionin për ndarjen e qendrave të votimit në Regjistrin Kombëtar deri në orën 24:00 të së njëjtës ditë. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ekzekuton automatikisht vendimet e kryetarit për ndarjen e qendrës së votimit sipas kriterit numerik dhe mbiemrit të zgjedhësit, në rastet kur përditësimet për ndarjen e qendrave të votimit nuk kryhen nga nëpunësit e zyrave të gjendjes civile. Qendrat e votimit me fraksion marrin automatikisht vendndodhjen e qendrës bazë.

Nëpunësit e zyrave të gjendjes civile në Bashkinë Kukës/njësitë administrative nën juridiksionin e saj kryejnë veprimet përkatëse në rubrikën e dedikuar në Regjistrin Kombëtar për përditësimin e përshkrimit të vendndodhjes së qendrës së votimit me fraksion, në rastet kur kryetari i komanduar në Bashkinë Kukës vendos që vendndodhja e qendrës së votimit me fraksion të jetë e ndryshme nga ajo e qendrës bazë.

12. Procedurat e parashikuara në pikat 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11, të këtij udhëzimi, kryhen për listën e zgjedhësve, datë 18.8.2023, që do të publikohet për zgjedhjet për kryetar të Bashkisë Kukës.

13. Në rastet kur kryetari i komanduar në detyrë në Bashkinë Kukës nuk përmbush detyrimet e parashikuara sipas pikave 5, 6, 7 dhe 8, të këtij udhëzimi, deri në publikimin e listës së zgjedhësve, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile kryen menjëherë procesin e ndarjes dhe/ose bashkimin e qendrave të votimit sipas kriterëve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, të cilat reflektohen në listën e zgjedhësve, datë 18.8.2023, për kryetar të Bashkisë Kukës.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile realizon bashkimin/ndarjen e qendrave të votimit, në përmbushje të këtij procesi, bazuar në kriterin numerik dhe mbiemrin e zgjedhësit. Qendrat e votimit me fraksion marrin automatikisht adresën e qendrës bazë.

Nëpunësit e zyrave të gjendjes civile në Bashkinë Kukës/njësitë administrative nën juridiksionin e saj kryejnë veprimet përkatëse në Regjistrin Kombëtar për përditësimin e vendndodhjes së qendrës së votimit, në rastet kur kryetari i komanduar në detyrë në Bashkinë Kukës ka vendosur që vendndodhja e qendrës së votimit me fraksion të jetë e ndryshme nga ajo e qendrës bazë.

14. Nëpunësit e zyrave të gjendjes civile në Bashkinë Kukës/njësitë administrative nën juridiksionin e saj, më datë 18.8.2023, printojnë listën e zgjedhësve nga Regjistri Kombëtar. Nëpunësit nënshkruajnë, vulosin listën e zgjedhësve për çdo qendër votimi, përfshirë këtu edhe institucionet e posaçme. Nëpunësit i dorëzojnë kryetarit të Bashkisë Kukës, të komanduar në detyrë, listën e zgjedhësve të nënshkruar dhe të vulosur.

15. Kryetari i komanduar në detyrë dërgon në KZAZ të 3 (tre) formatet e parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 2, të nenit 48, të Kodit Zgjedhor, jo më vonë se 35 ditë nga data e zhvillimit të zgjedhjeve për kryetar të Bashkisë Kukës.

16. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dërgon në KZAZ të 3 (tre) formatet e listës së zgjedhësve, në rast se nga kryetari i komanduar për Bashkinë Kukës nuk përmbushen kompetencat, sipas pikës 15 të këtij udhëzimi.

17. Zyrat e gjendjes civile në Bashkinë Kukës/njësitë administrative nën juridiksionin e saj, ku do



të zhvillohen zgjedhjet për kryetar të Bashkisë Kukës, zbatojnë dhe vendimet gjyqësore, sipas nenit 57, të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

18. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile publikon listën e zgjedhësve në formë elektronike, për zgjedhjet për kryetar të Bashkisë Kukës, në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Brendshme.

19. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile i dërgon për ruajtje Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave një kopje të printuar të listës së zgjedhësve, jo më vonë se 10 ditë pas shpalljes së listës së zgjedhësve për kryetar të Bashkisë Kukës.

20. Ngarkohen me zbatimin e këtij udhëzimi kryetari i Bashkisë Kukës, i komanduar në detyrë, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, zyrat e gjendjes civile në Bashkinë Kukës dhe në njësitë administrative nën juridiksionin e saj, si dhe institucionet e tjera shtetërore të parashikuara nga Kodi Zgjedhor.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Taulant Balla

URDHËR
Nr. 177, datë 2.8.2023

**PËR MIRATIMIN E PËRKTHIMIT NË
GJUHËN SHQIPE TË NDRYSHIMEVE
NË STANDARDIN NDËRKOMBËTAR TË
KONTABILITETIT (SNK) 12 – “TATIMI
MBI TË ARDHURAT”**

Në mbështetje të nenit 3, pika 4 dhe pika 5, të ligjit nr. 25, datë 10.5.2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 17.7.2019, “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e ndryshimeve në Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit (SNK) 12 “Tatimi mbi të ardhurat”.

2. Njësia ekonomike do të:

a) zbatojë paragrafët 4A dhe 88A menjëherë pas publikimit të këtyre ndryshimeve dhe në retrospektivë në përputhje me SNK8; dhe

b) zbatojë paragrafët 88B–88D për periudhat vjetore raportuese që fillojnë më 1 janar 2023 e në vijim. Nuk kërkohet që njësia ekonomike të japë informacionet shpjeguese të kërkuara nga këta paragrafë për periudha të ndërmjetme, që përfundojnë më 31 dhjetor 2023 apo më parë.

3. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE DHE
EKONOMISË
Delina Ibrahimaj

Reforma Tatimore Ndërkombëtare—Modeli i Rregullave të Shtyllës së Dytë

Ndryshime në SNK 12

**Ndryshime në
SNK 12 *Tatimet mbi të ardhurat***

Janë shtuar paragrafët 4A, 88A–88D (përfshirë titujt përkatës dhe shembulli pas paragrafit 88D) dhe 98M.



Objekti

...

4A Ky Standard zbatohet për tatimet mbi të ardhurat që rrjedhin nga legjislacioni tatimor i miratuar ose pothuajse i miratuar për zbatimin e modelit të rregullave të Shtyllës së Dytë të publikuar nga Organizata për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ekonomik (OBZHE), duke përfshirë legjislacionin tatimor që zbaton tatime plotësuese minimale kombëtare të përshkruara në ato rregulla. Ky legjislacion tatimor dhe tatimet mbi të ardhurat që rrjedhin prej tij, cilësohen këtu e në vijim si ‘Legjislacioni i Shtyllës së Dytë’ dhe ‘Tatimet mbi të ardhurat e Shtyllës së Dytë’. Njësia ekonomike nuk do të njohë dhe nuk do të japë informacion shpjegues mbi aktivet dhe detyrimet për tatime të shtyra të lidhura me legjislacionin e Shtyllës së Dytë, si përjashtim nga kërkesat e këtij Standardi.

...

Dhënia e informacioneve shpjeguese

...

Reforma tatimore ndërkombëtare—modeli i rregullave të Shtyllës së Dytë

88A Njësia ekonomike duhet të paraqesë që ka zbatuar përjashtimin në njohjen dhe dhënien e informacioneve shpjeguese mbi aktivet dhe detyrimet për tatime të shtyra të lidhura me tatimet mbi të ardhurat e Shtyllës së Dytë (shih paragrafin 4A).

88B Njësia ekonomike duhet të paraqesë veçmas shpenzimet (të ardhurat) aktuale tatimore të saj lidhur me tatimet mbi të ardhurat e Shtyllës së Dytë.

88C Në periudhat kur legjislacioni i Shtyllës së Dytë është i miratuar ose thuajse i miratuar por jo ende në fuqi, njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues të njohur ose të vlerësuar në mënyrë të arsyeshme, që ndihmon përdoruesit e pasqyrave financiare të kuptojnë ekspozimin e njësive ekonomike ndaj tatimeve mbi të ardhurat e Shtyllës së Dytë, pasojë e atij legjislacioni.

88D Për të plotësuar objektivin e paraqitjes në paragrafin 88C, njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues cilësor dhe sasior mbi ekspozimin e saj ndaj tatimeve mbi të ardhurat e Shtyllës së Dytë në fund të periudhës raportuese. Ky informacion mund të mos pasqyrojë të gjitha kërkesat specifike të legjislacionit të Shtyllës së Dytë dhe mund të jepet në formën e një intervali tregues. Në masën që informacioni nuk është i njohur apo i vlerësuar në mënyrë të arsyeshme, njësia ekonomike duhet të deklarojë atë efekt dhe të japë informacion shpjegues në lidhje me progresin e njësive ekonomike në vlerësimin e ekspozimit të saj.

Shembuj që ilustrojnë paragrafët 88C–88D

Shembuj të informacionit që njësia ekonomike mund të paraqesë në plotësim të objektivit dhe kërkesave në paragrafët 88C–88D përfshijnë:

- (a) informacionin cilësor si informacionin sesi njësia ekonomike është ndikuar nga legjislacioni i Shtyllës së Dytë dhe juridiksionet kryesore në të cilat mund të ekzistojnë ekspozimet ndaj tatimeve mbi të ardhurat e Shtyllës së Dytë; dhe
- (b) informacionin sasior të tillë si:
 - (i) një tregues i pjesës së fitimeve të njësive ekonomike, që mund të jenë objekt i tatimeve mbi të ardhurat e Shtyllës së Dytë dhe normën mesatare efektive tatimore të zbatueshme mbi këto fitime; ose
 - (ii) një tregues sesi norma mesatare efektive tatimore e njësive ekonomike do të ndryshonte nëse legjislacioni i Shtyllës së Dytë do të ishte në fuqi.

...

Data e hyrjes në fuqi

...

98M *Reforma Tatimore Ndërkombëtare—Modeli i Rregullave të Shtyllës së Dytë*, i publikuar në maj 2023, shtoi paragrafët 4A dhe 88A–88D. Njësia ekonomike do të:



(a) zbatojë paragrafët 4A dhe 88A menjëherë pas publikimit të këtyre ndryshimeve dhe në retrospektivë në përputhje me SNK8; dhe

(b) zbatojë paragrafët 88B–88D për periudhat vjetore raportuese që fillojnë më 1 janar 2023 e në vijim. Nuk kërkohet që njësia ekonomike të japë informacionet shpjeguese të kërkuara nga këta paragrafë për periudha të ndërmjetme, që përfundojnë më 31 dhjetor 2023 apo më parë.

International Tax Reform—Pillar Two Model Rules

Amendments to IAS 12

Amendments to IAS 12 *Income Taxes*

Paragraphs 4A, 88A–88D (including their related heading and the box after paragraph 88D) and 98M are added.

Scope

4A This Standard applies to income taxes arising from tax law enacted or substantively enacted to implement the Pillar Two model rules published by the Organisation for Economic Co-operation and Development (OECD), including tax law that implements qualified domestic minimum top-up taxes described in those rules. Such tax law, and the income taxes arising from it, are hereafter referred to as ‘Pillar Two legislation’ and ‘Pillar Two income taxes’. As an exception to the requirements in this Standard, an entity shall neither recognise nor disclose information about deferred tax assets and liabilities related to Pillar Two income taxes.

Disclosure

International tax reform—Pillar Two model rules

88A An entity shall disclose that it has applied the exception to recognising and disclosing information about deferred tax assets and liabilities related to Pillar Two income taxes (see paragraph 4A).

88B An entity shall disclose separately its current tax expense (income) related to Pillar Two income taxes.

88C In periods in which Pillar Two legislation is enacted or substantively enacted but not yet in effect, an entity shall disclose known or reasonably estimable information that helps users of financial statements understand the entity’s exposure to Pillar Two income taxes arising from that legislation.

88D To meet the disclosure objective in paragraph 88C, an entity shall disclose qualitative and quantitative information about its exposure to Pillar Two income taxes at the end of the reporting period. This information does not have to reflect all the specific requirements of the Pillar Two legislation and can be provided in the form of an indicative range. To the extent information is not known or reasonably estimable, an entity shall instead disclose a statement to that effect and disclose information about the entity’s progress in assessing its exposure.

Examples illustrating paragraphs 88C–88D

Examples of information an entity could disclose to meet the objective and requirements in paragraphs 88C–88D include:

- (a) qualitative information such as information about how an entity is affected by Pillar Two legislation and the main jurisdictions in which exposures to Pillar Two income taxes might exist; and
- (b) quantitative information such as:
 - (i) an indication of the proportion of an entity’s profits that might be subject to Pillar Two income taxes and the average effective tax rate applicable to those profits; or
 - (ii) an indication of how the entity’s average effective tax rate would have changed if Pillar Two legislation had been in effect.

**Effective date**

- 98M *International Tax Reform—Pillar Two Model Rules*, issued in May 2023, added paragraphs 4A and 88A–88D. An entity shall:
- (a) apply paragraphs 4A and 88A immediately upon the issue of these amendments and retrospectively in accordance with IAS 8; and
 - (b) apply paragraphs 88B–88D for annual reporting periods beginning on or after 1 January 2023. An entity is not required to disclose the information required by these paragraphs for any interim period ending on or before 31 December 2023.

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT**SEKSIONI I TRETË****ÇËSHTJA YZEIRAJ KUNDËR SHQIPËRISË***(Kërkesa nr. 70455/10)*

**VENDIM
STRASBURG
11 korrik 2023**

Ky vendim është i formës së prerë, por mund të bëhet objekt i rishikimit redaktues.

Në çështjen Yzeiraj kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si një Komitet i përbërë nga:

Georgios A. Serghides, *kryetar,*

Darian Pavli,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë,*

dhe Olga Chernishova, *zëvendësekretare e Seksionit,*

Duke pasur në konsideratë:

kërkesën (nr. 70455/10) kundër Republikës së Shqipërisë paraqitur pranë Gjykatës, në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”), më 25 nëntor 2010 nga një shtetas shqiptar, z. Pëllumb Yzeiraj, lindur në vitin 1975 dhe i mbajtur në arrest në Peqin (“kërkuesi”), i cili u përfaqësua nga z. P. Pavarini, një avokat që e ushtron ligjin në Torino;

vendimin për të njoftuar në lidhje me ankesën qeverinë shqiptare (“Qeveria”), përfaqësuar nga Agjenti i saj i asaj periudhe, znj. Alma Hicka, dhe në vijim nga z. O. Moçka, nga Avokatura e Shtetit; parashtrimet e palëve;

Pasi diskutoi me dyer të mbyllura më datë 20 qershor 2023,

Shpall vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në po atë datë:

LËNDA E ÇËSHTJES

1. Kërkesa ka të bëjë me pretendimin për padrejtësi në procesin penal ndaj kërkuesit, më konkretisht me mungesën e arsyeve të përshtatshme në vendimet vendase në kundërshtimin e alibisë së kërkuesit dhe me pretendimin se gjykatat vendase nuk thirrën dhe nuk morën në pyetje një sërë dëshmitarësh.

2. Më 3 nëntor 2004, kërkuesi u shpall fajtor nga Gjykata e Rrethit Fier për vrasjen e dy personave, J.I. dhe E.T., të cilët ishin në një automjet, duke lënduar rëndë dy të tjerë, B.K. dhe T.S., si edhe për mbajtjen pa leje të armëve, duke u dënuar me burgim të përjetshëm.

3. Gjatë hetimit, B.K. tha se nuk e kishte parë personin që kishte qëlluar, sepse ishte larguar nga skena. Në gjykatë, B.K. dëshmoi se e kishte parë kërkuesin të qëndronte rreth një metër e gjysmë larg nga automjeti i viktimave dhe t’i qëllonte me armë. Një oficer policie, F.M., i cili ishte i pranishëm në skenë, dëshmoi në gjykatë. Ai tha se besonte se autori i krimit kishte qëlluar me armë teksa ishte brenda në makinën e tij.

4. Kërkuesi nuk i pranoi akuzat ndaj tij duke deklaruar se në periudhën kur kishte ndodhur ngjarja ai kishte qenë në Greqi. Në gjykatë, ai paraqiti pasaportën e tij ku tregohet se kishte hyrë në Greqi më 22 mars 2002 dhe ishte kthyer në Shqipëri më 1 prill 2002. Një gjë e tillë u konfirmua me prova nga kontrolli kufitar.

5. Gjithashtu, u konfirmua se më herët kërkuesi kishte përdorur identitete të tjera, kryesisht si Kosta Papa, lindur në vitin 1975 në Sarandë. U konstatua se dy persona të tjerë me emrin Kosta Papa kishin hyrë në Shqipëri nga Greqia më 22 mars 2002, por



gjykatat vendase pranuan se asnjëri prej tyre nuk mund të kishte qenë kërkuesi, pasi ata kishin lindur në vitin 1928 dhe 1945 respektivisht.

6. Gjithashtu, gjykatat vendase hetuan nëse një person me emrin Yzeiri kishte kaluar kufirin midis Shqipërisë dhe Greqisë në periudhën përkatëse.

7. Kërkesat e kërkuesit se një sërë dëshmitarësh mund të kishin konfirmuar alibinë e tij, më konkretisht Th.P dhe S.K., të cilët jetonin në Greqi dhe më herët kishin dhënë deklarata autentike, një ekspert i mjekësisë i cili mund të jepte shpjegime për kapacitetin e dëshmitarit të vetëm okular, B.K., për të dhënë dëshmi për rrethanat e goditjes me armë ku ai ishte lënduar rëndë, dhe një ekspert balistik i cili mund të rindëronte skenën e krimit dhe të verifikonte deklaratimet e B.K., u rrëzuan me arsyen se faktet në lidhje me dënimin e kërkuesit tashmë ishin provuar me anë të provave të dhëna nga B.K. dhe dëshmitarëve të tjerë. Ndaj kërkuesit nuk ekzistonte asnjë provë materiale.

8. Dënimi i kërkuesit u la në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë dhe Gjykata e Lartë më 8 mars 2008 dhe 17 shkurt 2010, respektivisht. Ankesa e tij kushtetuese u rrëzua nga Gjykata Kushtetuese më 28 tetor 2010.

VLERËSIMI I GJYKATËS

PRETENDIM PËR SHKELJE TË NENIT 6 §§ 1 DHE 3 (D) TË KONVENTËS

9. Gjykata shprehet se kjo ankesë nuk është e pambështetur në fakte sipas interpretimit të nenit 35 §3 (a) të Konventës, apo e papranueshme për shkaqe të tjera. Për këtë arsye, ajo duhet të deklarohet e pranueshme.

10. Parimet e përgjithshme në lidhje me të drejtën për të thirrur dëshmitarë për mbrojtjen janë përmbledhur në çështjen *Murtazaliyeva kundër Rusisë* [DHM], nr. 36658/05, §§ 150-68, 18 dhjetor 2018, ndërsa parimet në lidhje me detyrën e gjykatave për të dhënë arsye për vendimet e tyre në çështjen *Garvia Ruiz kundër Spanjës* [DHM], nr. 30544/96, 26, GJEDNJ 1999-I. Garancitë në paragrafin 3 (d) të nenit 6 janë aspekte të posaçme për të drejtën për gjykim të drejtë, parashikuar në paragrafin 1 të kësaj dispozite, dhe sipas nenit 6 §1 përgjegjësia kryesore e Gjykatës është vlerësimi i drejtësisë së përgjithshme në procesin penal. Në këtë vlerësim, Gjykata e konsideron procesin si një të tërë (shih *Schatschascheli kundër Gjermanisë* [DHM], nr. 9154/10, §§ 100–101, GJEDNJ 2015).

11. Fillimisht, duhet të mbahet në konsideratë se mbrojtja e kërkuesit përqendrohej në pretendimin se ai kishte qenë në Greqi në periudhën nga data 22 mars dhe 1 prill 2002. Duke qenë se vepra penale konkrete ndodhi më 25 mars 2002, informacionet nga pasaporta e kërkuesit dhe policia e kontrollit kufitar krijonin një mbështetje të fortë për alibinë e tij (shih paragrafin 4 më sipër). Teksa gjykatat vendase kundërshtojnë mocionin e kërkuesit për prova të tjera në lidhje me këtë aspekt, ato nuk arsyetonin se të dhënat për kalimin kufitar në pasaportë nuk ishin të besueshme, apo se kishte indicie se këto të dhëna ishin falsifikuar.

12. Gjykatat vendase nuk e pranonin pasaportën e kërkuesit si provë bindëse mbështetur në argumentin se kërkuesi kishte përdorur identitete të tjera, kryesisht atë të Kosta Papas. Edhe pse provat e paraqitura tregonin se dy persona me atë emër kishin kaluar kufirin nga Shqipëria në Greqi më 22 mars 2002, gjykatat kishin gjykuar se asnjë prej tyre nuk ishte kërkuesi (shih paragrafin 5 më sipër).

13. Në vijim, nuk ekzistonte asnjë shpjegim për mënyrën se si janë përpjekur gjykatat vendase për të verifikuar nëse një person me emrin Yzeiri që kishte kaluar kufirin kishte të bënte me çështjen, pasi ky nuk ishte mbiemri i kërkuesit (shih paragrafin më sipër).

14. Mbështetur në sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se duket se gjykatat vendase e kanë kundërshtuar alibinë e kërkuesit me supozimin e vetëm se ai mund të jetë kthyer në Shqipëri me një emër tjetër, por nuk kanë shpjeguar arsyetimin e tyre dhe as nuk i janë referuar ndonjë prove për të mbështetur këtë përfundim. Në këtë mënyrë, gjykatat vendase nuk kanë ofruar arsye të përshtatshme për rrëzimin e alibisë së kërkuesit.

15. Në vijim, Gjykata vëren se kërkesa për të thirrur Th.P dhe S.K si dëshmitarë ishte arsyetuar mjaftueshëm dhe kishte lidhje me çështjen për shkak të vlerës dëshmuese të dëshmive të tyre të drejtpërdrejta në lidhje me alibinë e kërkuesit, gjë që mund të kishte përforcuar pozicionin e mbrojtjes apo edhe mund të kishte çuar në lirimin e kërkuesit. Megjithatë, vendimi i gjykatave vendase nuk shqyrtonte rëndësinë e dëshmive të tyre të mundshme dhe nuk ofronin mjaftueshëm arsye për vendimin për rrëzimin e kërkesës së kërkuesit që këta dëshmitarë të dëgjoheshin (shih *Murtazaliyeva*, cituar më sipër, §§ 160–61, dhe krahaso me *Bregvadze kundër Gjeorgjisë* [Komiteti], nr. 49284/09, § 28, 17



janar 2019). Fakti se dy dëshmitarët kishin dhënë deklaratat e tyre autentike nuk mund të konsiderohet mjaftueshëm për të përjashtuar nevojën për dhënien e drejtpërdrejtë të dëshmisë nga ana e tyre për një aspekt aq të rëndësishëm të mbrojtjes së kërkuarit, në mungesë të shpjegimeve shtesë. Pa kaluar në vlerësimin e provave, Gjykata gjykon se kërkuari duhej të kishte pasur mundësinë, në mbështetje të parimit të barazisë së armëve, të paraqiste pranë gjykatave vendase provat për mbrojtjen e tij që mund ta kishin shfajësuar.

16. Së fundmi, Gjykata vëren se dëgjimi i dy dëshmitarëve gjatë procesit ishte e rëndësishme jo vetëm për shkak të rëndësisë së natyrës mbrojtëse të parashtrimeve që ata mund të kishin bërë, por edhe sepse provat kryesore tek të cilat u mbështetën gjykatat për shpalljen e kërkuarit fajtor – dëshmia e B.K. – rezultojnë të kenë pasur të meta për shkak të mospërputhjeve. Më konkretisht, gjatë hetimit dëshmitari kishte thënë se kush kishte qëlluar me armë ndaj tij dhe viktimave të tjera, pasi kjo gjë nuk kishte ndodhur pas shpinës së tij, teksa ai po mbaronte punë me një tregtar të valutës në trotuar, ndërsa në gjykatë ai dëshmoi se kishte parë kërkuarin teksa qëndronte në anën tjetër të makinës së viktimës dhe qëllonte me armë ndaj tyre. Deklarata e fundit nuk përputhej me deklaratën dhënë nga oficeri i policisë F.M., i cili kishte qenë i pranishëm në skenën e të shtënave dhe kishte dëshmuar se autori i krimit kishte qëlluar nga brenda një makine tjetër (shih paragrafin 3 më sipër). Këto mospërputhje të rëndësishme nuk ishin adresuar nga gjykatat vendase, që i kishin refuzuar të gjithë dëshmitarët shtesë (shih paragrafin 7 më sipër) dhe thjesht kishin pranuar argumentet e prokurorisë, në dëm të gjyqimit të drejtë në përgjithësi (krahajo me *Murtaçaliyeva*, cituar më sipër, § 175).

17. Mbështetur në sa më sipër, Gjykata konstaton se duke refuzuar të dëgjonin dëshmitarët shtesë në gjykim, gjykatat vendase krijuan një avantazh të padrejtë në favor të prokurorisë, dhe për pasojë, e privuan kërkuarin nga një mundësi praktike për të kundërshtuar efektivisht akuzat ndaj tij.

18. Gjykata gjykon se refuzimet e mësipërme nga gjykatat vendase dëmtonin në përgjithësi gjykimin e drejtë në procesin përkatës.

19. Për këtë arsye, është shkelur neni 6 §§1 dhe 3 (d) i Konventës.

ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

20. Kërkuari i kërkoj Gjykatës të urdhëronte qeverinë të “rimbursonte dëmshpërblimet e tij”, por nuk specifikonte ndonjë pretendim për shpërblim të drejtë apo për kostot dhe shpenzimet. Në këtë mënyrë, Gjykata thekson se një vendim në të cilin ajo konstaton një shkelje e vendos shtetin përgjegjës përpara detyrimit ligjor për ta ndërprerë shkeljen dhe për të kompensuar pasojat e saj. Duke pasur në konsideratë natyrën e ankesës së kërkuarit dhe të shkeljes së konstatuar, Gjykata gjykon se forma më e përshtatshme për korrigjim në çështjen konkrete do të ishte rihapja e procesit penal ndaj kërkuarit, nëse ai e kërkon një gjë të tillë.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME,

1. *E shpall* kërkesën të pranueshme;

2. *Gjykon* se është shkelur neni 6 §§1 dhe 3 (d) i Konventës.

Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më datë 11 korrik 2023, sipas Rregullit 77 §§2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Olga Chernishova
ZËVENDËSSEKRETARE

Georgios A. Serghides
KRYETAR

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË

ÇËSHTJA MUÇAJ KUNDËR SHQIPËRISË
(Kërkesa nr. 37814/10)

VENDIM
STRASBURG
11 korrik 2023

Ky vendim është i formës së prerë, por mund të bëhet objekt i rishikimit redaktues.

Në çështjen Muçaj kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si një Komitet i përbërë nga:

Georgios A. Serghides, *kryetar*,

Darian Pavli,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë*,

dhe Olga Chernishova, *zëvendësekrete e Seksionit*,

Duke pasur në konsideratë:



kërkesën (nr. 37814/10) kundër Republikës së Shqipërisë paraqitur pranë Gjykatës, në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”), më 28 qershor 2010, nga një shtetas shqiptar, z. Mariglen Muçaj, lindur në vitin 1978 (“kërkuesi”), i cili u përfaqësua nga z. A. Lamaj, një avokat që e ushtron ligjin në Tiranë;

vendimin për të njoftuar për ankesën qeverinë shqiptare (“Qeveria”), përfaqësuar nga Agjentja e saj, znj. A. Hicka, dhe në vijim nga z. O. Moçka, nga Avokatura e Shtetit;

parashtrimet e palëve;

Pasi diskutoi me dyer të mbyllura më datë 20 qershor 2023,

Shpall vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në po atë datë:

LËNDA E ÇËSHTJES

1. Kërkesa konkrete ka të bëjë kryesisht me: i. kohëzgjatjen dhe shkaqet për paraburgimin e kërkuesit sipas nenit 5 § 3 të Konventës; ii. nëse është shkelur e drejta e kërkuesit për t’u prezumuar i pafajshëm, garantuar sipas nenit 6 §2 të konventës; si edhe ankesa të tjera në lidhje me drejtësinë në proces.

I. PROCESI PENAL KUNDËR KËRKUESIT

2. Më 9 gusht 2009, katër oficerë policie u vranë si pasojë e shkëmbimit të zjarrit midis D.D., një të arratisuri nga hetimi penal, dhe E.Xh. me forcat e policisë. Telefoni i E.Xh. u konfiskua në skenën e krimit, dhe rezultoi se kërkuesi e kishte telefonuar vazhdimisht E.Xh., të cilit i ishte ngarkuar detyra të ndihmonte dhe mbështeste D.D. në kryerjen e krimeve.

3. Në muajin gusht 2009, ndaj kërkuesit nisi procesi penal.

A. Procedurat në lidhje me paraburgimin

4. Me kërkesë të prokurorit, më 22 nëntor 2009, Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda (në vijim “GJSHPKR”) dha urdhër për paraburgimin e kërkuesit, me akuzën për shpërdorim detyre për kontaktet e pretenduara me individë të përfshirë në vrasjen e përmendur më sipër të katër oficerëve të policisë, sipas nenit 244 të Kodit të Procedurës Penale (“KPP”) me arsyen se ekzistonte rreziku për t’iu fshehur drejtësisë.

5. Sipas dyshimit të arsyeshëm se kërkuesi kishte kryer veprën penale të shpërdorimit të detyrës, gjykata vlerësoi se kërkuesi kishte lidhje të ngushta

shoqërore me E.Xh. Ai kishte arritur të siguronte një uniformë policie për E.Xh. në Drejtorinë e Policisë Korçë, ku kërkuesi kishte shërbyer si oficer policie. Fotografitë tregonin se grada në uniformën e policisë që kishte veshur D.D. përkonte me gradën e kërkuesit. Pozicioni i pretenduar i D.D. në forcat e policisë në dokumentin e falsifikuar të identifikimit që ai kishte me vete përkonte me atë të kërkuesit.

6. Më 23 nëntor 2009, kërkuesi u arrestua, dhe më 26 nëntor 2009 ai doli përpara GJSHPKR-së, që konfirmoi paraburgimin e kërkuesit në mbështetje të nenit 248 të KPP-së, me arsyen e rrezikut për t’iu fshehur drejtësisë, pa e detajuar më shumë këtë aspekt.

7. Më 14 dhjetor 2009, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda (Gjykata e Apelit për KR) la në fuqi vendimin e GJSHPKR-së. Ajo gjykante se provat tregonin se ekzistonte dyshimi i arsyeshëm se kërkuesi kishte kryer krimin e shpërdorimit të detyrës. Gjithashtu, edhe pse kërkuesi kishte dijeni për aktet kriminalë të E.Xh. dhe D.D., ai kishte rënë dakord t’i ndihmonte. Apeli i kërkuesit u rrëzua nga Gjykata e Lartë më 11 janar 2010.

8. Më 18 shkurt 2010, kërkuesi depozitoi një ankesë kushtetuese pranë Gjykatës Kushtetuese. Ankesa u rrëzua më 17 qershor 2010 me arsyen se nuk ishte në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.

9. Kërkesat e mëtejshme të kërkuesit më 1 mars dhe 24 dhjetor 2010, që paraburgimi i tij të hiqej ose të zëvendësohej me masa të tjera u rrëzuan nga gjykatat vendase me arsyetimin se kushtet për të cilat urdhërohej paraburgim nuk kishin ndryshuar. Referimet e kërkuesit për kalimin e afatit dhe përfundimin e hetimit nuk u adresuan nga gjykatat vendase.

B. Procesi në Gjykatën e Rrethit

10. Më 17 dhjetor 2012, çështja ndaj kërkuesit u transferua në Gjykatën e Rrethit Durrës (në vijim “Gjykata e Rrethit”), e cila më 24 dhjetor 2012 e shtyu ndalimin e kërkuesit në paraburgim deri në gjykimin e çështjes. Gjykata e Rrethit mori në konsideratë, *inter alia*, vonesat në proces të shkaktuara nga bashkë-i-pandehuri i kërkuesit D.D. dhe arriti në përfundimin se paraburgimi i kërkuesit ishte i justifikuar dhe i lejueshëm sipas legjislacionit, edhe nëse ai i kalonte formalisht afatet statutores.

11. Më 6 shkurt 2013, Gjykata e Rrethit e shpalli kërkuesin fajtor sipas akuzës dhe e dënoi me katër vite dhe tetë muaj burgim. Duke qenë se koha e kaluar në paraburgim, e përlogaritur sipas raportit të



zbatueshëm të një dite e gjysmë, e tejkalonte dënimin e tij, gjykata urdhëroi lirimin e menjëhershëm të kërkuesit. Në vijim, kërkuesi u ndalua të mbante detyrë publike për një periudhë prej tre vitesh. Kërkuesi nuk e apeloj dënimin e tij.

C. Mbulimi në media dhe deklarata e Kryeministrit

12. Në vitin 2009 dhe 2010, u publikuan një sërë artikujsh duke iu referuar çështjes ndaj kërkuesit në terma të ashpër.

13. Më 25 janar 2010, Buletini Zyrtar i Ministrisë së Brendshme citoi një deklaratë të Kryeministrit ku ai kritikonte korrupsionin në radhët e policisë, duke iu referuar kërkuesit si një person që kishte ndihmuar vrasësit e katër policëve në Durrës dhe e quante atë kriminel. Kërkuesi nuk e ka adresuar këtë çështje në ndonjë proces vendas.

II. LIGJI DHE PRAKTIKA VENDASE PËRKATËSE

14. Në vendimin e saj nr. 57, të datës 21 dhjetor 2012, Gjkata Kushtetuese e konsideronte prezumimin e pafajësisë (garantuar nga neni 30 i Kushtetutës) si një nga elementet përbërëse të gjykimit të drejtë.

15. Në vendimin e saj nr. 47, të datës 7 nëntor 2011, Gjkata Kushtetuese theksonte se parimi i prezumimit të pafajësisë shkelej nëse vendimi i një gjykate reflektonte një opinion sipas së cilit një i pandehur ishte fajtor përpara se të provohej i pafajshëm sipas ligjit. Edhe pse nuk ekzistonte një deklaratë formale për këtë aspekt, ishte e mjaftueshme që arsyetimi nënkuptonte se i akuzuari ishte fajtor.

VLERËSIMI I GJYKATËS

I. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 5 §3 TË KONVENTËS

16. Kërkuesi u ankua se kohëzgjatja e paraburgimit sipas nenit 5 §3 kishte qenë e tepërt.

A. Pranueshmëria

17. Qeveria vlerësonte se kërkuesi nuk kishte shteruar mjetet vendase sepse, edhe pse ai ishte ankuar përpara gjykatave vendase për paraburgimin. Ai nuk kishte ngritur ankesa për drejtësinë e përgjithshme në proces.

18. Kërkuesi e kundërshtoi paraburgimin e tij vazhdimisht dhe pa pasur sukses përpara gjykatave kompetente. Për këtë arsye, kundërshtimi i qeverisë duhet të rrëzohet.

19. Gjkata thekson se kjo ankesë nuk është e pambështetur në fakte sipas interpretimit të nenit 35

§3 (a) të Konventës apo e papranueshme për ndonjë arsye tjetër. Për këtë arsye, ajo duhet të deklarohet e pranueshme.

B. Meritat

20. Ligji përkatës vendas paraqitet në çështjen *Delijorgji kundër Shqipërisë* nr. 6858/11, §§ 39–50, 28 prill 2015, dhe *Hysa kundër Shqipërisë*, nr. 52048/16, §§ 26–41, 21 shkurt 2023.

21. Gjkata thekson se vijueshmëria e dyshimit të arsyeshëm është një kusht *sine qua non* për vlefshmërinë e paraburgimit, por pas kalimit të një afati të caktuar, kjo nuk është më e mjaftueshme. Në raste të tilla, Gjkata duhet të vendosë nëse arsye të tjera dhënë nga autoritetet gjyqësore vazhdojnë të justifikojnë privimin e lirisë. Në rastin kur këto arsye janë “të përshtatshme” dhe “të mjaftueshme”, Gjkata duhet të konstatojë nëse autoritetet kompetente vendase kanë treguar “kujdes të veçantë” gjatë procesit (shih: *Buzadji kundër Republikës së Moldavisë* [DHM], nr. 23755/07, §§ 84–91, 102, GJEDNJ 2016, dhe *Merabishvili kundër Gjeorgjisë* [DHM], 72508/13, §§ 222–25, 28 nëntor 2017).

22. Për çështjen konkrete, Gjkata thekson se kërkuesi kaloi tre vite, dy muaj dhe trembëdhjetë ditë në paraburgim. Për një periudhë të tillë të gjatë në parim, do të nevojiteshin arsye të forta për privimin e dikujt nga liria. Gjkata është e kënaqur me faktin se gjykatat vendase, mbështetur në provat e disponueshme, kishin gjykuar se ekzistonte dyshimi arsyeshëm se kërkuesi kishte kryer veprën e shpërdorimit të detyrës. Megjithatë, gjykatat vendase vijuan t'i referoheshin rrezikut për t'iu fshehur drejtësisë si arsyeja kryesore për paraburgimin e zgjatur të kërkuesit, pa bërë ndonjë përpjekje për të provuar se si kjo gjente zbatim konkretisht në çështjen e kërkuesit, por thjesht duke vënë në dukje rëndësinë e akuzave. Gjkata vëren se serioziteti i veprës ose pasojat e saj nuk përbëjnë arsye të pavarura që justifikojnë ndalimin me burgim, dhe në vetvete mund të mosjustifikojnë privimin e një të dyshuari nga liria e tij ose saj, në rast se nuk janë shqyrtuar gjatë vlerësimit të ekzistencës së arsyeve të arsyeshme sipas së cilave lejohet burgimi (shih *Hysa* cituar më sipër, §74). Gjithashtu, argumentet si kalimi i afatit dhe përfundimi i hetimit ngritur nga kërkuesi në parashtrimet e tij nuk ishin adresuar nga gjykatat vendase. Rezulton se gjykatat vendase nuk kishin marrë në konsideratë as ndonjë masë



alternativë sigurie përtej një deklarimi formal (shih paragrafin 9 më sipër).

23. Hetimi dhe procesi gjyqësor zgjatën rreth tre vite e gjysmë. Akuzat ndaj D.D. dhe kërkuesit ishin mjaftueshëm të rënda dhe faktet e çështjes ishin disi komplekse. Në të njëjtën kohë, Gjykata vëren se kërkuesi ishte akuzuar për vetëm një vepër, dhe për të justifikuar paraburgimin e kërkuesit, Gjykata e Rrethit Durrës i ishte referuar vonesave në proces shkaktuar nga avokati mbrojtës i të bashkë-të-pandehurit të tij (shih paragrafin 10 më sipër). Në mungesë të ndonjë mase marrë nga organet gjyqësore për të adresuar këto vonesa, nuk mund të thuhet se sistemi gjyqësor penal vendas e kishte trajtuar çështjen e kërkuesit me “kujdes të veçantë” (krahaso me *Štrtecký kundër Sllovakisë*, nr. 55844/12, §§ 67–70, 5 qershor 2018).

24. Konstatohet se është shkelur neni 5 § 3 i Konventës.

II. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 6 § 2 TË KONVENTËS

25. Qeveria kundërshtoi parashtrimin se kërkuesi nuk kishte shteruar në mënyrën e duhur mjetet vendase në lidhje me ankesën e tij sipas nenit 6 §2 të Konventës se prezumimi i tij i pafajësisë ishte shkelur nga mbulimi mediatik për gjykimin ndaj tij dhe nga disa deklarata të Kryeministrit.

26. Gjykata, fillimisht, vëren se kërkuesi nuk pretendon se ai nuk kishte mjete vendase për të shteruar në lidhje me këtë aspekt. Në vijim ajo sjell në vëmendje se parimi i prezumimit të pafajësisë është mbi të gjitha një masë procedurale, dhe një prej elementeve për një gjykim penal të drejtë të parashikuar nga neni 6 i Konventës (shih: *Kostas kundër Greqisë* nr. 53466/07, § 29, 24 maj 2011 dhe *Mamaladze kundër Gjeorgjisë*, nr. 9487/19, § 63–65, 3 nëntor 2022). Në vijim, Gjykata vëren se në parim, Konventa është e zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë në urdhrin ligjor të Shqipërisë, e drejta për t’u prezumuar i pafajshëm garantohet në Kushtetutën e Shqipërisë dhe praktika e Gjykatës Kushtetuese tregon se ajo e ka adresuar atë çështje si aspekt i një gjykimi të drejtë (shih paragrafin 15 më sipër). Një petition individual në Gjykatën Kushtetuese, në parim, është një mjet efektiv dhe kërkohet për qëllime shterimi në lidhje me të drejtën e një kërkuesi për gjykim të drejtë, sipas nenit 6 të Konventës (shih: *mutatis mutandis*, *Balliu kundër Shqipërisë* (vendim), nr. 74727/01, 30 shtator 2004; *Beshiri dhe të Tjerë kundër Shqipërisë*, nr. 7352/03, §§

30–34, 22 gusht 2006; dhe *Jakupi kundër Shqipërisë* (vendim), nr. 11186/03, 1 dhjetor 2009). Megjithatë, kërkuesi nuk e ka ngritur kurrë këtë çështje as gjatë procesit penal në ankesën e tij përpara Gjykatës Kushtetuese, dhe as në ndonjë proces të veçantë të së drejtës civile (shih paragrafin 13 më sipër).

27. Për sa më sipër, ankesa duhet të deklarohet e papranueshme në përputhje me nenin 35 §1 dhe 4 të Konventës për mosshfrytëzim të mjeteve vendase.

III. PRETENDIME TË TJERA PËR SHKELJE TË KONVENTËS

28. Kërkuesi u ankua edhe në mbështetje të nenit 6 §1 se paraburgimi i tij duhej të ishte urdhëruar nga një gjykatë e zakonshme penale dhe jo nga Gjykata e Krimeve të Rënda.

29. Mbështetur në të gjitha materialet në zotërimin e saj, dhe për sa çështjet për të cilat është bërë një ankesë janë në kompetencën e saj, Gjykata konstaton se ato nuk përbëjnë një shkelje të së drejtave dhe lirive parashikuar në Konventë ose në protokollin e saj. Për këtë arsye, kjo pjesë e ankesës është e pambështetur në fakte dhe duhet të rrëzohet në mbështetje të nenit 35 § 3 (a) dhe 4 të Konventës.

ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

30. Kërkuesi kërkoi 80,000 euro për dëmin pasuror dhe 25,000 euro për dëmin jopasuror dhe 64,000 euro për kostot dhe shpenzimet e bëra për të dalë përpara Gjykatës.

31. Qeveria i kundërshtoi kërkesat e kërkuesit.

32. Gjykata nuk konstaton ndonjë lidhje rastësore midis shkeljes së konstatuar dhe pretendimit për dëm pasuror. Duke pasur në konsideratë natyrën e shkeljes së konstatuar, Gjykata, duke vendosur mbi baza të barabarta, i akordon kërkuesit 1,900 euro për dëmin jopasuror plus çdo taksë që mund të jetë e tarifueshme.

33. Mbështetur në dokumentet në zotërimin e saj, Gjykata e vlerëson të arsyeshme që të akordojë 2,000 euro për kostot dhe shpenzimet e bëra për procesin në Gjykatë, plus çdo taksë që mund t’i tarifohet kërkuesit.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME,

1. I shpall ankesat në mbështetje të nenit 5 §3 të Konventës të pranueshme, dhe pjesën tjetër të ankesave të papranueshme;

2. Gjykon se është shkelur neni 5 §3 i Konventës;

3. Gjykon:



a) se shteti përgjegjës duhet t'i paguajë kërkuesit, brenda tre muajve, shumat në vijim, të cilat duhet të konvertohen në monedhën e shtetit përgjegjës në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes:

i. 1,900 euro (një mijë e nëntëqind euro) plus çdo taksë që mund të tarifohet për dëmin jopasuror;

ii. 2,000 euro (dy mijë euro) plus çdo taksë që mund t'i tarifohet kërkuesit për kostot dhe shpenzimet;

b) se që prej përfundimit të periudhës tremujore përmendur më sipër deri në shlyerjen e shumave të mësipërme, për to do të paguhet interes i thjeshtë në normën e barasvlershme me normën margjinale të huadhënies të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagesës plus tre pikë përqindje;

4. Rrëzon pjesën tjetër të pretendimit të kërkuesit për shpërblim të drejtë.

Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më datë 11 korrik 2023, sipas Rregullit 77 §§2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Olga Chernishova
ZËVENDËSSEKRETARE

Georgios A. Serghides
KRYETAR

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 65320/09

DEA 7.CO KUNDËR SHQIPËRISË

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 27 qershor 2023 si një Komitet i përbërë nga:

- Georgios A. Serghides, *kryetar*;
- Darian Pavli,
- Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë*,
- dhe Olga Chernishova, *zëvendëssekretare e*

Seksionit,

- Duke mbajtur në konsideratë:

- kërkesën (nr. 65320/09) kundër Republikës së Shqipërisë depozituar pranë Gjykatës, në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”) më 9 dhjetor 2009 nga “Dea 7.Co” sh.p.k., një kompani me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në Shqipëri

(“kompania kërkuese”) dhe përfaqësuar nga z. I. Alushi, një avokat që e ushtron ligjin në Tiranë;

- vendimin për të bërë me dije në lidhje me kërkesën qeverinë shqiptare (“Qeveria”), përfaqësuar nga Agjenti i saj në atë periudhë, znj. L. Mandija, dhe në vijim nga z. O. Moçka, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit;

- Pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

LËNDA E ÇËSHTJES

1. Kompania kërkuese operon në fushën e transportit të pasagjerëve. Çështja ka të bëjë me të drejtën e kompanisë kërkuese për t’iu drejtuar gjykatës në mbështetje të nenit 6 §1 të Konventës, për të kundërshtuar një njoftim për detyrimet tatimore.

2. Pas një inspektimi tatimor, më 3 janar 2008, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (“DPT”) rivlerësoi përgjegjësitë tatimore të kompanisë kërkuese dhe i dërgoi një “njoftim për vlerësimin tatimor” (“njoftim-vlerësimi tatimor”). DPT-ja e urdhëroi kompaninë kërkuese të paguante 3,828,759 lekë (rreth 31,140 euro në periudhën konkrete), në lidhje me detyrimet tatimore të padeklaruara. Gjithashtu, DPT-ja vendosi ndaj kompanisë kërkuese detyrimin për të paguar shumën prej 1,766,938 lekë (rreth 14,371 euro) për shtesat dhe penalitetet.

A. Procesi administrativ

3. Më 1 shkurt 2008, kompania kërkuese apeloj njoftimin e vlerësimit tatimor pranë Drejtorisë së Apelimit Tatimor, e cila, më 3 mars 2008, e deklaroi apelimin të papranueshëm, pa i shqyrtuar meritat e tij. Ajo gjykante se kompania kërkuese nuk kishte respektuar nenin 43 të ligjit për procedurat tatimore (ligji nr. 8560, i datës 22 dhjetor 1999, i ndryshuar) sipas së cilit, përpara se të apelojë një detyrim tatimor, një tatimpagues duhet të paguajë principalin e shumës së kontestuar.

4. Pas apelimit të kompanisë kërkuese pranë organit administrativ të nivelit të dytë, më konkretisht Komisioni i Apelimit Tatimor, më 23 prill 2008, organi refuzoi të shqyrtonte meritat e apelimit mbështetur në të njëjtat arsye.

B. Procesi gjyqësor

5. Më 21 maj 2008, kompania kërkuese ndërmori një akt ligjor pranë Gjykatës së Rrethit Mat ndaj zyrës rajonale të tatimeve. Ajo kundërshtonte njoftimin për vlerësimin tatimor dhe vendimet administrative që kishin rrëzuar apelimet e saj. Ajo argumentonte se njoftimi tatimor ishte në



kundërshtim me legjislacionin e zbatueshëm tatimor.

6. Më 17 korrik 2008, Gjykata e Rrethit Mat e ndërpreu procedurën për shkak të mosshfrytëzimit të mjeteve administrative. Ajo gjykoi se kompania kërkuese nuk kishte përmbushur detyrimin për të parapaguar shumat e tatimeve të kontestuar përpara se t'i kundërshtonte ato, dhe për pasojë, organet administrative të shkallës së parë dhe të dytë nuk kishin shqyrtuar meritat e apelimit të saj.

7. Më 21 korrik 2008, kompania kërkuese depozitoi një apelim për disa pika të ligjit pranë Gjykatës së Lartë. Ajo parashtronte se e kishte kundërshtuar rivlerësimin tatimor në kohën e duhur përpara organeve administrative. Gjithashtu, ajo argumentonte se ajo nuk ishte një “tatimpaguese” sipas interpretimit të legjislacionit të zbatueshëm për tatimet, për këtë arsye, nuk kishte detyrimin për të paguar shumat e vendosura nga administrata e tatimeve.

8. Më 2 tetor 2008, Gjykata e Lartë e kundërshtoi apelimin dhe la në fuqi arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë.

9. Më 2 prill 2009, kompania kërkuese depozitoi një apelim kushtetues ku përsëriste argumentet e saj të mëparshëm (shih paragrafin 7 më sipër).

10. Më 5 korrik 2009, Gjykata Kushtetuese e deklaroi apelimin të papranueshëm pasi ai ngrinte çështje që kishin të bënin me interpretimin e ligjit dhe vlerësimin e provave, të cilat ajo i konsideronte jashtë fushës së juridiksionit të saj.

11. Përpara Gjykatës, kompania kërkuese u ankua, në mbështetje të nenit 6 §1 të Konventës, për mohimin e të drejtës për t'iu drejtuar gjykatës për të apeluar detyrimet e saj tatimore. Sipas nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës, kompania kërkuese u ankua gjithashtu se vlerësimi tatimor kishte vendosur një barrë të tepërt për gëzimin e paqtë të pronës së saj.

VLERËSIMI I GJYKATËS

A. Neni 6 §1 i Konventës

12. Çështjet tatimore, si ato që janë përpara Gjykatës, janë pjesa kryesore përbërëse e prerogativave të autoritetit publik, ku natyra publike e marrëdhënies midis tatimpaguesit dhe komunitetit mbetet mbizotëruese, pavarësisht efekteve pasurore që pasjellin mosmarrëveshjet tatimore për tatimpaguesin. Rezulton se neni 6 §1 i Konventës nuk është i zbatueshëm sipas aspektit të tij civil (shih

së fundmi, *Vegotex International S.A. kundër Belgjikës* ([DHM]), nr. 49812/09, §66, 3 nëntor 2022).

13. Megjithatë, aspekti penal i nenit 6 §1 është zbatuar për shtetas tatimore të cilat nuk janë parashikuar si kompensim pasuror për dëmin, por si masë për të parandaluar përsëritjen e shkeljes (*Jussila kundër Finlandës* [DHM], nr. 73053/01, § 38, GJEDNJ 2006-XIV).

14. Në çështjen konkrete, përveç detyrimeve tatimore të rivlerësuar, autoritetet vendosën ndaj kërkuetit një sërë shtesash dhe penalitetesh (shih paragrafin 2 më sipër), të cilat *prima facie* rezultojnë të kenë një natyrë ndëshkuese. Megjithatë, nuk është e nevojshme të shqyrtohet në detaje kuadri ligjor dhe natyra e atyre shtesave dhe penaliteteve, pasi në çdo rast, ankesa e kërkuetit është e papranueshme për arsyet e paraqitura më poshtë.

15. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës nuk është absolute. Ajo mund të jetë objekt kufizimesh lejuar sipas interpretimit, veçanërisht në lidhje me kushtet e pranueshmërisë së një apelimi. Megjithatë, këto kufizime nuk duhet të kufizojnë ushtrimin e së drejtës në mënyrë të tillë, apo në masë të tillë, që të cenohet thelbi i së drejtës. Ato duhet të ndjekin një qëllim legjitim dhe duhet të ekzistojë një proporcionalitet i arsyeshëm midis mjeteve të zbatuara dhe qëllimit që synohet të arrihet (shih *Omar kundër Francës* ([DHM] nr. 24767/94, § 34, 29 korrik 1998).

16. Në çështjen konkrete, kufizimi ndaj së drejtës së kompanisë kërkuese për t'iu drejtuar gjykatës rridhte prej kërkesës për të parapaguar shumën kryesore të borxhit tatimor të rivlerësuar përpara se të kundërshtohet rivlerësimi i borxhit. Kompania kërkuese nuk kundërshtoi – dhe Gjykata nuk ka arsye të gjykojë – në lidhje me aspektin se kërkesa nuk ndiqte një qëllim legjitim (krahaso me arsyetimin në *Leduc kundër Francës*, (vendim) [Komiteti], nr. 16382/16, § 28, 17 tetor 2017, dhe vendimet e cituara në të).

17. Në lidhje me proporcionalitetin, në parashtrimet e saj përpara gjykatave vendase dhe Gjykatës, kompania kërkuese u mbështet vetëm në argumentin se, sipas ligjit vendas, nuk i kërkohej të paguante detyrimet tatimore të rivlerësuar. Megjithatë, kompania kërkuese nuk ishte ankuar përpara autoriteteve vendase se shuma që i kërkohej të parapaguante ishte e tepërt ose se ajo shumë vendoste një barrierë të paarsyeshme dhe ndaluese për të ushtruar të drejtën e saj për t'iu drejtuar



gjykatës. Me fjalë të tjera, ajo u ankua për detyrimin për të paguar sipas ligjit vendas dhe jo për pamundësinë e saj për të respektuar atë detyrim (shih, për një situatë të ngjashme, *Tcaciuc dhe të Tjerë kundër Rumanisë* (vendim) [Komiteti], nr. 43695/05 dhe 5 të tjerë, §28, 4 shtator 2018, me referenca të tjera; dhe krahaso me *Loncke kundër Belgjikës*, nr. 20656/03, § 51, 25 shtator 2007, ku kërkuksi ngriti një ankesë për të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës). Në mungesë të një argumenti për këtë aspekt, Gjykata nuk mund të konstatojë se kufizimi i të drejtës së kompanisë kërkuese për t'iu drejtuar gjykatës është jo proporcional.

18. Së fundmi, në lidhje me argumentin se autoritetet vendase nuk respektuan ligjin kur vendosën që kërkuksi duhej të parapaguante shumën përkatëse përpara se të paraqiste një apelim ndaj saj, Gjykata nuk konstatonte ndonjë arsye për të gjykuar se ai konstatim ishte arbitrar apo qartazi i paarsyeshëm (shih *Moreira Ferreira kundër Portugalisë* (nr. 2) [DHM], nr. 19867/12, §§83 dhe 85, 11 korrik 2017).

19. Për sa më sipër, veçanërisht duke marrë në konsideratë se kompania kërkuese nuk kishte kundërshtuar aspektin se kufizimi statutor i së drejtës së saj për t'iu drejtuar gjykatës ishte jo proporcional, Gjykata konstaton se çështja nuk paraqet ndonjë shkellje të së drejtës së kompanisë kërkuese për t'iu drejtuar gjykatës, sipas nenit 6 §1 të Konventës.

B. Neni 1, i protokollit nr. 1 të Konventës

20. Nëse një kërkuks nuk respekton kërkesat vendase të pranueshmërisë, kërkesa e tij apo e saj pranë Gjykatës, në parim, duhet të deklarohet e papranueshme për mosshfrytëzim të mjeteve vendase (shih *Vučković dhe të Tjerë kundër Serbisë* (kundërshtimi paraprak) [DHM], nr. 17153/11 dhe 29 të tjerë, § 72, 25 mars 2014).

21. Në çështjen konkrete, padia vendase e kërkuksit ishte shpallur e papranueshme, sepse nuk ishin shteruar mjetet administrative përpara se kërkuksi t'i drejtohej gjykatës, dhe ai rezultat nuk ishte kontradiktor me të drejtën e kompanisë kërkuese për t'iu drejtuar gjykatës (shih paragrafin 19 më sipër). Për pasojë, ankesa sipas nenit 1, të protokollit nr. 1 të Konventës, pranë Gjykatës është e papranueshme për mosshkrim të mjeteve vendase sipas nenit 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME,

E shpall kërkesën të papranueshme.

Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më datë 20 korrik 2023.

Olga Chernishova
ZËVENDËSSEKRETARE

Georgios A. Serghides
KRYETAR

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË

ÇËSHITJA HAMITAJ KUNDËR SHQIPËRISË

(Kërkesa nr. 11254/11)

VENDIM
STRASBURG
20 korrik 2023

Ky vendim është i formës së prerë, por mund të bëhet objekt i rishikimit redaktues.

Në çështjen Hamitaj kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si një Komitet i përbërë nga:

Ioannis Ktistakis, *kryetar*,

Darian Pavli,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë*,

dhe Viktoriya Maradudina, *zëvendëssekretare e Përkohshme e Seksionit*,

Pasi diskutoi me dyer të mbyllura më datë 29 qershor 2023,

Shpall vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në po atë datë:

PROCEDURA

1. Çështja nisi me një kërkesë kundër Shqipërisë depozituar në Gjykatë, në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”) më 15 janar 2011.

2. Qeveria shqiptare (“Qeveria”) u njoftua mbi kërkesën në mbështetje të nenit 6 § 1 të Konventës, në lidhje me pretendimin për kohëzgjatjen e tepërt të procesit, sipas nenit 13 të Konventës për mungesën e një mjeti efektiv për të adresuar kohëzgjatjen e procesit, si edhe në mbështetje të



nenit 1 të Protokollit nr. 1 për një shkelje të të drejtave të kërkuarit mbi pronën.

FAKTET

3. Detajet e kërkuarit dhe informacioni që ka lidhje me kërkesën paraqiten në tabelën bashkëlidhur.

4. Kërkuari u ankua për kohëzgjatje të tepërt të procedurave civile, duke përfshirë ato në Gjykatën e Lartë, sipas nenit 6 §1 të Konventës. Kërkuari paraqiti edhe ankesa të tjera në mbështetje të Konventës.

LIGJI

I. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 6 §1 TË KONVENTËS

5. Kërkuari u ankua kryesisht se kohëzgjatja e procesit civil konkret nuk ishte në përputhje me kërkesën për “afat të arsyeshëm” (për më shumë detaje shih tabelën bashkëlidhur). Ai u mbështet në nenin 6 §1 të Konventës.

6. Gjykata thekson se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procesit duhet të vlerësohet në mbështetje të rrethanave të çështjes dhe duke iu referuar kritereve në vijim: kompleksiteti i çështjes, sjellja e kërkuarit dhe e autoriteteve përkatëse, dhe se çfarë ishte në rrezik për kërkuarin në mosmarrëveshje (shih *Frydlander kundër Francës* [DHM], nr. 30979/96, §43, GJEDNJ 2000-VII, *Gazsó kundër Hungarisë*, nr. 48322/12, § 15, 16 korrik 2015; dhe *Topallaj kundër Shqipërisë*, nr. 32913/03, § 75, 21 prill 2016).

7. Në çështjet kryesuese *Luli dhe të Tjerë kundër Shqipërisë*, nr. 64480/09 dhe 5 të tjerë, 1 prill 2014, dhe *Mishgioni kundër Shqipërisë*, nr. 18381/05, 7 dhjetor 2010, Gjykata tashmë ka konstatuar një shkelje në lidhje me aspekte të ngjashme në çështjen konkrete.

8. Pasi shqyrtoi të gjithë materialin e paraqitur pranë saj, Gjykata nuk ka gjetur fakte apo argumente që mund të justifikojnë kohëzgjatjen e përgjithshme të procesit në nivel kombëtar. Mbështetur me praktikën e saj gjyqësore në lidhje me çështjen, Gjykata konstaton se në çështjen konkrete kohëzgjatja e procesit ishte e tepërt dhe nuk përmbushte kërkesën për “afat të arsyeshëm”.

9. Për këtë arsye, kjo ankesë është e pranueshme dhe konstatohet shkelje e nenit 6 §1 të Konventës.

II. PRETENDIME PËR SHKELJE TË TJERA SIPAS PRAKTIKËS GJYQËSORE TË KONSOLIDUAR

10. Kërkuari u ankua edhe në mbështetje të nenit 13 të Konventës për mungesë të mjeteve të brendshme në lidhje me ankesën e tij për kohëzgjatjen e procesit. Duke mbajtur në konsideratë faktet e çështjes, parashtrimet e palëve dhe konstatimet e saj në paragrafin 9 më sipër, Gjykata vlerëson se ka shqyrtuar çështjen kryesore ligjore në kërkesën konkrete. Ajo konstaton se nuk është e nevojshme që të jepet një vendim i veçantë për këtë kërkesë (shih: *Qendra për Burimet Ligjore në emër të Valentin Câmpeanu kundër Rumanisë* [DHM], nr. 47848/08, § 156, GJEDNJ 2014, dhe *Habilaj kundër Shqipërisë* [Komiteti], nr. 2480/10, § 14, 15 shtator 2022).

III. ANKESAT E TJERA

11. Kërkuari u ankua edhe në mbështetje të nenit 1, të Protokollit nr. 1, në lidhje me legalizimin e ndërtimeve të paligjshme të palëve të treta në pronën e kërkuarit.

12. Gjykata thekson parimet që udhëheqin statusin e viktimës së një kërkuari. Një vendim apo masë e favorshme për një kërkuar në parim nuk është mjaftueshëm për të privuar kërkuarin nga statusi i tij apo i saj si “viktimë” nëse autoritetet vendase nuk kanë njohur shprehimisht apo në thelb, dhe më pas të kenë ofruar korrigjim për, shkeljen e Konventës (shih: *Murray kundër Holandës* [DHM], nr. 10511/10, § 41, 26 prill 2016, dhe *Nada kundër Zvicrës* [DHM], nr. 10593/08, § 128, GJEDNJ 2012). Njohja dhe korrigjimi shpesh vijnë si rezultat i shterimit të mjeteve vendase (shih: *Staykov kundër Bullgarisë*, nr. 49438/99, §89, 12 tetor 2006, dhe *C dhe D kundër Kroacisë* (vendim), nr. 43317/07, 14 tetor 2010).

13. Duke u kthyer tek rrethanat e çështjes konkrete, Gjykata konstaton se kërkuari depozitoi kërkesën e tij pranë Gjykatës teksa procesi vendas ishte ende në vijim. Ndërkohë, gjykatat vendase kishin njohur pronësinë e kërkuarit ndaj truallit dhe i kishin akorduar kompensim në shumën prej 3,135,000 lekë. Kërkuari nuk u ankua për shumën e kompensimit të akorduar dhe nuk u ankua as për faktin se në vend të prishjes së ndërtimeve pa leje i ishte akorduar kompensim.

14. Gjykata thekson se në rastin kur kërkuari pranon një shumë kompensimi si zgjidhje për një padi civile dhe heq dorë nga përdorimi i mëtejshëm



i mjeteve vendase, ai ose ajo, përgjithësisht, nuk ka më mundësinë që të pretendojë të jetë viktimë në lidhje me këto çështje (shih *mutatis mutandis*, Powell *kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vendim), nr. 45305/99, GJEDNJ 2000 V).

15. Gjykata thekson se njohja e të drejtave të pronësisë së një kërkuessit është e barabartë me njohjen e një shkelje. Kërkuessit i është akorduar edhe kompensimi i përshtatshëm për të cilin ai nuk u ankua. Për këtë arsye, ai nuk mund të konsiderohet më viktimë e shkeljes së pretenduar. Rrjedhimisht, kjo ankesë duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35 §3 (a) dhe 4 të Konventës.

IV. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

16. Neni 41 i Konventës parashikon:

“Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe, nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.”

Viktoriya Maradudina

ZËVENDESEKRETARE E PËRKOHSHME

17. Për sa i përket dokumenteve në zotërimin e saj dhe praktikës së saj gjyqësore (shih veçanërisht *Luli dhe të Tjerë*, cituar më sipër, dhe *Mishojoni*, gjithashtu cituar më sipër), Gjykata e vlerëson të arsyeshme të akordojë shumën në tabelën bashkëlidhur.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME,

1. E shpall ankesën në lidhje me kohëzgjatjen e procesit në mbështetje të nenit 6 të Konventës, të pranueshme, *konstaton* se nuk është e nevojshme që kërkesa të shqyrtohet veçantë në mbështetje të nenit 13 të Konventës, dhe e shpall pjesën tjetër të kërkesës të papranueshme;

2. Gjykon se është shkelur neni 6 §1 i Konventës në lidhje me kohëzgjatjen e tepërt të procesit civil;

3. Gjykon:

a) se shteti përgjegjës duhet t'i paguajë kërkuessit, brenda tre muajve, shumën e përcaktuar në tabelën bashkëlidhur, e cila duhet të konvertohet në monedhën e shtetit përgjegjës në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes;

b) se nga përfundimi i periudhës tremujore, përmendur më sipër, deri në shlyerje për shumën e mësipërme duhet të paguhet interes i thjeshtë në normën e barasvlershme me normën marginale të huadhënies të Bankës Qendrore Evropiane gjatë

Ioannis Ktistakis

KRYETAR

periudhës së mospagesës plus tre pikë përqindje.

Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më datë 20 korrik 2023, sipas rregullit 77 §2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

SHTOJCË

KËRKESË ME ANË TË SË CILËS PARAQITET ANKESA SIPAS NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS (KOHËZGJATJE E TEPËRT E PROCESIT CIVIL)

Kërkesa nr. Data e paraqitjes	Emri i kërkuessit Viti i lindjes	Nisja e procesit ose data e hyrjes në fuqi të Konventës për Shqipërinë (2 tetor 1996)	Përfundimi i procesit	Kohëzgjatja në total Nivelet e juridiksionit	Shuma e akorduar për dëmin jopasuror për kërkuess (në euro) ¹
11254/11 15.1.2011	Frederik HAMITAJ 1949	8.2.2006	14.5.2012	6 vite e tre muaj e 7 ditë 3 nivele juridiksioni	600

¹ Plus çdo taksë që mund t'i tarifohet kërkuessit.



GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 27039/10

SAFET SELIMAJ KUNDËR SHQIPËRISË

(shih tabelën bashkëlidhur)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 29 qershor 2023 si një Komitet i përbërë nga:

Ioannis Ktistakis, *kryetar*,

Darian Pavli,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë*,

dhe Viktoriya Maradudina, *zëvendëssekretare e*

Përkohshme e Seksionit,

Duke mbajtur në konsideratë kërkesën e mësipërme depozituar më 19 prill 2010,

Pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

FAKTET DHE PROCEDURA

Kërkuesi, z. Safet Selimaj, ka lindur në vitin 1958.

Ankesat e kërkuesit në mbështetje të nenit 1, të protokollit nr. 1 të Konventës, për mungesën e kompensimit si rezultat i përmbajtjes së truallit të tij nga një hidrocentral, iu komunikuan qeverisë shqiptare (“Qeveria”), e cila paraqiti parashtrimet e saj për pranueshmërinë dhe meritat.

Parashtrimet iu dhanë kërkuesit, i cili u ftua të paraqiste parashtrimet e tij.

Me anë të shkresës dërguar me postë rekomande, kërkuesi u ftua të bënte me dije Gjykatën nëse kishte pasur ndonjë zhvillim që nga përditësimet e fundit të palëve, dhe nëse dëshironte të vijonte me kërkesën. Gjithashtu, vëmendja e kërkuesit u orientua te neni 37 §1 (a) i Konventës, që parashikon se Gjykata mund ta përjashtojë një kërkesë nga lista e saj e çështjeve kur rrethanat çojnë në përfundimin se kërkuesi nuk ka për qëllim ta ndjekë kërkesën. Gjykata nuk ka marrë përgjigje për këtë shkresë (shih detajet në tabelën bashkëlidhur).

LIGJI

Mbështetur në sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se mund të konsiderohet se kërkuesi nuk dëshiron që të vijojë me kërkesën (neni 37 §1 (a) i Konventës). Gjithashtu, në mbështetje të nenit 37 §1 *in fine*, Gjykata nuk konstaton rrethana të veçanta, në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut, sipas përcaktimit në Konventë dhe Protokolleve të saj, çka do të kërkonte shqyrtimin e mëtejshëm të kërkesës.

Për sa më sipër, është e përshtatshme që çështja të përjashtohet nga lista.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME,

Vendos ta përjashtojë kërkesën nga lista e saj e çështjeve.

Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më datë 20 korrik 2023.

Viktoriya Maradudina
ZËVENDËSSEKRETARE
E PËRKOHSHME

Ioannis Ktistakis
KRYETAR

SHTOJCË

KËRKESË E BËRË NË MBËSHTETJE TË NENIT 1, TË PROTOKOLLIT NR. 1, TË KONVENTËS

Kërkesa nr. Data e paraqitjes	Emri i kërkuesit Viti i lindjes	Data e shkresës së regjistruar të Gjykatës	Data e marrjes së shkresës së regjistruar
27039/10 19.4.2010	Safet SELIMAJ 1958	23.3.2023	3.4.2023



VENDIM
Nr. 160, datë 8.6.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS
(Për përfundimin e procedurës së falimentimit)

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, e përbërë nga:

GJYQTAR: ARDIT KUKA

Në Peshkopi, sot më datë 8.6.2023, në seancë gjyqësore, publike, mori në shqyrtim çështjen civile, që i përket:

KËRKUES: Shoqëria tregtare NEKU sh.p.k., regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS: L01405006G, me seli në adresën: rr. “Pazari”, Terminali Bulqizë, përfaqësuar nga administratorja e falimentimit znj. Shpresa Breçani.

OBJEKTI: Përfundimin e procedurës së falimentimit të debitorit NEKU sh.p.k.

Me pjesëmarrjen e:

1. REDEN sh.p.k., në mungesë.
2. ALBSIG sh.p.k. (kreditor), në mungesë.
3. “Energy & Air” sh.p.k., në mungesë.
4. “Shega Trans” sh.a. (kreditor), në mungesë.
5. “INSIG Tirana 2” sh.a. (kreditor), në mungesë.
6. ALBCHROME sh.p.k. (kreditor), në mungesë.
7. “Sigma Inter Albania” sh.a. (kreditor), në mungesë.
8. Arjan Daci person fizik (kreditor), në mungesë.
9. Abedin Toska person fizik (kreditor).
10. Ujësajllësi Bulqizë sh.a. (kreditor), në mungesë.
11. “Irdi Oil” sh.p.k. (kreditor) në mungesë.
12. EGI K. sh.p.k. (kreditor), në mungesë.
13. “Euro Trade Company”, në mungesë.
14. “Kurti Trans” sh.p.k. (kreditor), përfaqësuar nga administratori z. Bujar Kurti.
15. NELI sh.p.k., përfaqësuar nga z. Urim Koçi.
16. Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj (kreditor), përfaqësuar nga znj. Gladiola Mika me autorizim.
17. Përfaqësues i punëmarrësve z. Refik Spahiu (kreditor).

18. Alma Neli (ortake e shoqërisë), përfaqësuar nga z. Taulant Naço me prokurë të posaçme.

19. Lulzim Kurti (ortake e shoqërisë), përfaqësuar nga z. Taulant Naço me prokurë të posaçme.

20. Fatmir Neli (ortake e shoqërisë), përfaqësuar nga z. Taulant Naço me prokurë të posaçme.

21. Farie Koçi (ortake e shoqërisë), përfaqësuar nga z. Taulant Naço me prokurë të posaçme.

22. Verie Neli (ortake e shoqërisë), përfaqësuar nga z. Taulant Naço me prokurë të posaçme.

BAZA LIGJORE: Nenet 13, 14, 15, 17, të ligjit nr. 110/2016, datë 27.10.2016, “Për falimentimin”. Neni 41, 42, 153 dhe 334 e vijues të Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, pasi shqyrtoi aktet e administruara në dosje dhe raportin e paraqitur nga administratorja e përkohshme znj. Shpresa Breçani

VËREN:

I. Rrethanat e faktit

Nga hetimi gjyqësor rezulton se: Kërkuesi, shoqëria tregtare NEKU sh.p.k. (ish subjekti BRISEL sh.p.k.) është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me objekt të aktivitetit: “Studim, vlerësim gjeologjik inxhinierik i trojeve për objekte civile, ekonomike deri në 5 kate dhe mbi 5 kate; studim-vlerësim gjeologjik-minerar për objekte të mëdha H/C, për aeroporte, bazamente me ngarkesa të mëdha; shfrytëzim, prodhim, përpunim dhe tregtim me shumicë e pakicë, import-eksport i mineraleve të grupit I, II, III dhe IV sipas ligjit minerar; ruajtje përdorim prodhim, tregtim me shumicë, import-eksport të lëndëve dhe materialeve plasëse etj.”. Shoqëria ka selinë në qytetin e Bulqizës, rr. “Pazari”, me administrator z. Alfred Kurti, ka kapital të regjistruar në shumën 230,000,000 (dyqind e tridhjetë milionë) lekë. Gjatë ushtrimit të aktivitetit tregtar, veçanërisht vitet e fundit, shoqëria kërkuese ka pasur vështirësi në shlyerjen e detyrimeve të saj. Sipas raportit të paftësisë paguese, të paraqitur paraprakisht nga kërkuesi, detyrimet arrijnë në total në vlerën 748, 631, 343 (shtatëqind e dyzet e tetë milionë e gjashtëqind e tridhjetë e një mijë e treqind e dyzet e tre) lekë. Me vendimin e datës 30.4.2021, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të shoqërisë tregtare NEKU sh.p.k. ka vendosur deklarinimin e fillimit të procedurave të falimentimit me anë të likuidimit të shoqërisë dhe paraqitjen e kërkesës në gjykatë. Në datën 7.5.2021, shoqëria tregtare NEKU sh.p.k. i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër me kërkesën me objekt: “Fillimin e procedurës së falimentimit për likuidim të shoqërisë



tregtare NEKU sh.p.k. (NUIS: L01405006G). Caktimin e administratorit të përkohshëm të falimentimit. Vendosjen e masave të sigurisë mbi të gjitha pasuritë e luajtshme, të paluajtshme, si dhe të drejtat e debitorit NEKU sh.p.k. (NUIS: L01405006G).

Përpara shqyrtimit të çështjes në themel, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër (ndryshuar emërtimi me vendimin nr. 162, datë 6.4.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, me efekt nga data 1.5.2023), kryesisht verifikoi parakushtet procedurale të juridiksionit, kompetencës lëndore dhe legjitimitetit procedural. Bazuar në nenet 36, 41, 42 të Kodit të Procedurës Civile, nenet 3, pika 9, dhe 11, të ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”, duke qenë se debitori NEKU sh.p.k. ka selinë dhe qendrën kryesore në interesin në qytetin e Bulqizës, çështja përfshihet në juridiksionin gjyqësor dhe është në kompetencën lëndore e territoriale të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër. Në nenin 3, të ligjit nr. 110/2016, përcaktohet se gjyqtar i falimentit caktohet një nga gjyqtarët e seksionit tregtar të gjykatës përkatëse. Pavarësisht mungesës së ndarjes në seksione, në zbatim të dekretit të Presidentit të Republikës nr. 1501, datë 29.5.1996, “Për krijimin e seksioneve për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, tregtare e familjare pranë gjykatave të rretheve”, që është pjesërisht në fuqi ende sot, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër është kompetente për shqyrtimin e çështjeve tregtare, sikurse çështja objekt gjykimi. Në kuadër të masave të përkohshme të kërkuara nga debitori, me vendimin e ndërmjetëm datë 19.5.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër caktoi si administratore të përkohshme të falimentimit znj. Shpresa Breçani për të zëvendësuar debitorin shoqërinë tregtare NEKU sh.p.k., për administrimin e pasurive të saj të luajtshme dhe të paluajtshme, të cilës iu ngarkua gjithashtu edhe detyra e ekspertës, në përputhje me nenin 19, të ligjit nr. 110/2016, duke mos disponuar me hapjen e procedurës së falimentimit para depozitimit të raportit financiar të administratorit të përkohshëm. Pas paraqitjes së raportit dhe marrjes së mendimit të administratorit të përkohshëm, nëse ekzistojnë shkaqe për të filluar procedurën e falimentimit, me vendimin e datës 16.6.2021, Gjykata deklaroi hapjen (fillimin) e procedurës së falimentimit datë 16.6.2021, ora 15:59 dhe caktoi administratore të falimentimit znj. Shpresa Beçani, duke u bërë të ditur të gjithë

kreditorëve të shoqërisë tregtare NEKU sh.p.k., të njoftojnë menjëherë administratoren e falimentimit, për pretendimet dhe të drejtat e tyre të siguruar mbi pasuritë e debitorit. Me vendimin e datës 17.7.2021, “Për plotësimin e vendimit”, ndër të tjera u caktua komiteti i përkohshëm i kreditorëve i përbërë nga 5 anëtarë, kërkesë e nenit 29, pika dh) të ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”. Gjykata vlerësoi se kërkesi plotëson kërkesat për hapjen e procedurës së falimentimit, pasi janë përmbushur të gjitha rekuizitat e përcaktuara në nenin 29, të ligjit nr. 110/2016. Sipas raportit paraprak të paaftësisë paguese, detyrimet arrijnë në total në vlerën 748, 631, 343 (shtatëqind e dyzet e tetë milionë e gjashtëqind e tridhjetë e një mijë e treqind e dyzet e tre) lekë. Provohet se shoqëria nuk ka likuiditete të mjaftueshme dhe pasivet kalojnë aktivet e saj. Ky subjekt rezulton me humbje në tri vitet e fundit të aktivitetit. Shoqëria tregtare NEKU sh.p.k. ka paraqitur në cilësinë e provave:

- Raportin e paaftësisë paguese të debitorit shoqërisë tregtare NEKU sh.p.k.;
- Ekstraktin historik, printuar nga formati elektronik dhe vulosur elektronikisht nga QBZ-ja, datë 5.5.2021;
- Listën e kreditorëve, deri në datën 31.12.2021, gjithsej 16 subjekte;
- Listën e debitorëve, gjithsej 2, të cilët sipas raportit të administratores së përkohshme janë shlyer tërësisht në rrugë jobankare;
- Listën e proceseve përmbarimore;
- Deklaratën personale të përfaqësuesit ligjor, administratorit të shoqërisë, datë 6.5.2021, ku thuhet se në arkën e shoqërisë ndodhet shuma prej 6,000,000 (gjashtë milionë) lekë, që mbulon shpenzimet e procedurës së falimentimit;
- Vendimi i Asamblesë së Ortakëve, datë 30.3.2021, për deklarimin e fillimit të procedurave të falimentimit;
- Referuar akteve të depozituara, nuk ka pasuri të paluajtshme të regjistruara në emër të shoqërisë, detyrë që mbetet objekt verifikimi gjatë procedurës së falimentimit;
- Deklaratë mbi vërtetësinë e informacionit;
- Raportin e administratorit të përkohshëm datë 16.6.2021.

Me shkresën nr. 7 prot., datë 31.1.2022, “Raport i administratores së falimentimit të shoqërisë në procedurë falimentimi për hartimin e planit të likuidimit, datë 31.1.2022” dhe shkresën nr. 10 prot.,



datë 21.2.2022, “Shtojca 1, për plotësimin e planit të likuidimit sipas rekomandimeve të gjykatës komunikuar me shkresën nr. 316/28, datë 7.2.2022”, administratorja e falimentimit ka depozituar në sekretarinë gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër planin e likuidimit për shoqërinë tregtare NEKU sh.p.k. Administratori i falimentimit ka përpiluar tabelën, duke ndarë, në përputhje me ligjin, kreditorët sipas kategorive: kreditorë të falimentimit, kreditorë të siguruar, kreditorë të preferuar, kreditorë të pasiguruar, kreditorë fundorë. Këto akte u janë njoftuar kreditorëve nga gjykata me shkresën nr. 316/28, datë 24.2.2022. Mbështetur në nenin 138, paragrafi 3, të ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”, kreditorëve u është bërë e ditur se kanë të drejtë të njihen me planin e likuidimit, duke u paraqitur në kryesekretari për të marrë kopje dhe të paraqesin komente dhe vërejtje për planin, nëse kanë të tilla, brenda 15 ditëve nga data e depozitimit të tij në gjykatë. Nëse nuk kanë komente dhe vërejtje do të vijohet me ekzekutimin e tij, konform nenit 140, të ligjit nr. 110/2016.

Rezultoi se masa e falimentimit të debitorit NEKU sh.p.k. përbëhet nga: 1. Rezervat e nxjerrshme dhe gjendja e lëndës së parë të prodhuar (485 ton lëndë e parë krom dhe 19,595 rezervë minerare e vlerësueshme) në sasinë dhe specifikat e pasqyruara në raportin e ekspertit dhe faturën tatimore datë 27.9.2022; 2. Mjete motorike: a) një fadromë tip Fiat- Hitach, vit prodhimi 1998; b) Mikrobus i markës “Mercedes Benz”; c) Motor kompresor “Atlas Copco” vit prodhimi 1996; dhe 3. Dy aparate shpërthyes. Sasia e lëndës së parë të prodhuar dhe rezervave të nxjerrshme është përlllogaritur në bazë të bilancit nr. 123 prot., datë 30.6.2022 të grupit të inxhinierëve “*Innovation Development Engineering*” sh.p.k. Ndërsa mjetet dhe makineritë janë vlerësuar në bazë të raportit të vlerësimit datë 14.7.2022, të inxhinieres mekanike znj. Etleva Selimaj, në vlerë totale 2,291,848 lekë dhe më konkretisht fadroma (eskavatori) tip “Fiat-Hitach E-190” në vlerën 124,723 lekë, mikrobusi tip “Mercedes Benz” me targa AA 286 HM në vlerën 202,500 lekë, automjeti tip “*Land Rover*” me targa AA 485 LR, në vlerën 1,026,294 lekë dhe moto kompensori “Atlas Copco GA 110” në shumën 278,489 lekë dhe aparatet shpërthyes në vlerën 63,360 lekë.

Referuar neneve 149 e vijues të Kodit Civil, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, konsiderohen si të drejta pasurore edhe lejet administrative të fituara nga këto subjekte, në rastin konkret leja e shfrytëzimit të subjektit NEKU sh.p.k. Rezulton se ky subjekt zotëron lejen minerare nr. 1489/2, datë 2.8.2010, në objektin Galeria A, Bulqizë, me kuotë +1200, deri në nivelin e Galerisë B+1200, ku është konstatuar rezerva minerare e sipërcituar objekt i masës së falimentimit.

Administratori i falimentimit kërkoi që të procedohet me mënyrën e shitjes së aktiveve të debitorit me marrëveshje të drejtpërdrejtë, kërkesë që është miratuar në mënyrë unanime nga Komiteti i Kreditorëve, bazuar në Standardin Kombëtar nr. 5, “Mënyra dhe procedura e realizimit të shitjeve të aktiveve të debitorit”, pika VII, “Shitja nga marrëveshje e drejtpërdrejtë”, miratuar me VKM-në nr. 733, datë 13.11.2019, “Për miratimin e standardeve kombëtare të administrimit të masës së falimentimit”. Kjo kërkesë u vlerësua e bazuar në ligj, pasi shitja e aktiveve në mënyrë të drejtpërdrejtë, mënjanon vonesat që mund të shkaktohen nga format e tjera të shitjes si ankandet, duke mbrojtur më mirë interesat e kreditorëve. Merret në konsideratë të veçantë, se kjo mënyrë shitje e aktiveve të debitorit është marrë me miratimin unanime të Komitetit të Kreditorëve. Gjykata vijoi me miratimin e planit të likuidimit të debitorit NEKU sh.p.k. në procedurë falimentimi. Kjo masë ka rezultuar në total në vlerën 43,347,257 (dyzet e tre milionë e treqind e dyzet e shtatë mijë e dyqind e pesëdhjetë e shtatë lekë) sipas aktit “Vlerësim përfundimtar datë 30.9.2022” të administratores së falimentimit.

Nga procedura e shitjes me marrëveshje të drejtpërdrejtë të masës së falimentimit është shpallur fitues shoqëria tregtare “RAFA Group” sh.p.k., me administrator Ardit Kukeli, midis pesë ofertuesve dhe që ka paraqitur ofertën më të lartë në shumën 430,000 USD (katërqind e tridhjetë mijë dollarë amerikanë). Palët kanë lidhur kontratën e shitjes datë 8.9.2022 (kontrata paraprake) dhe më pas kontratën e shitjes së pasurive të luajtshme nr. 2006 rep. dhe nr. 912 kol., datë 28.9.2022, për shitjen e masës së falimentimit kundrejt shumës së sipërcituar dhe blerësi ka paguar në dy këste shumën, fillimisht duke paguar 20% në datën 8.9.2022 dhe pjesën e mbetur në datën 23.9.2022.



Referuar listës së shpërndarjes përfundimtare të emërtuar “Vlerësim përfundimtar datë 30.9.2022” të krijuar nga shitja e masës së falimentimit për t’u shpërndarë kreditorëve në shumën 43,347,257 (dyzet e tre milionë e treqind e dyzet e shtatë mijë e dyqind e pesëdhjetë e shtatë lekë), në mënyrë të detajuar dhe në formë tabelore përcaktohen pagesat që duhet t’u bëhen kreditorëve të falimentimit dhe shpërblimet për administratorin e falimentimit dhe komitetin e kreditorëve. Konkretisht lista e detyrimeve ndaj kreditorëve është si në vijim:

B. KREDITORË TË FALIMENTIMIT

B/1. KREDITORË TË SIGURUAR:

1. “Kurti Trans” L82 sh.p.k. - detyrim në shumën 120,000 (njëqind e njëzet milionë) lekë që rrjedh nga kontrata e pengut.

2. NELI sh.p.k.- detyrim në shumën 15,000,000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë që rrjedh nga kontrata e pengut

B/2. KREDITORË TË PREFERUAR

1. Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj - 341,791,137 lekë, që rrjedhin nga mospagimi i tatimit të fitimit, kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe taksës minerare.

B/3. KREDITORË TË PASIGURUAR

1. REDEN sh.p.k. – 13,823,416 (trembëdhjetë milionë e tetëqind e njëzet e tre mijë e katërqind e gjashtëmbëdhjetë lekë);

2. ALBSIG sh.a. – 4,392,803 (katër milionë e treqind e nëntëdhjetë e dy mijë e tetëqind e tre) lekë;

3. “Energy & Air” sh.p.k. – 750,240 (shtatëqind e pesëdhjetë mijë e dyqind e dyzet) lekë;

4. “Shega Trans” sh.a. – 5,192,191 (pesë milionë e njëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e njëqind e nëntëdhjetë e një) lekë;

5. “INSIG Tiranë 2” sh.a. – 992,000 (nëntëqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë;

6. ALBCHROME sh.p.k. – 3,600,000 (tre milionë e gjashtëqind mijë) lekë;

7. “Sigma Inter Albania” sh.a. – 3,101,892 (tre milionë e njëqind e një mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e dy) lekë;

8. Arjan Daci person fizik – 555,236 (pesëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e dyqind e tridhjetë e gjashtë) lekë;

9. Abedin Toska person fizik – 589,596 (pesëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë;

10. Ujësjellësi Bulqizë sh.a. – 322,246 (treqind e njëzet e dy mijë e dyqind e dyzet e gjashtë) lekë;

11. Irdi Oil sh.p.k. – 2,542,246 (dy milionë e pesëqind e dyzetë e dy mijë e dyqind e dyzetë e gjashtë) lekë;

12. Egi K. sh.p.k. – 90,000 (nëntëdhjetë mijë) lekë;

13. “Euro Trade Company” – 2,835,000 (dy milionë e tetëqind e tridhjetë e pesë mijë) lekë.

B/4. KREDITORË FUNDORË

1. Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj – 219,989,088 lekë, që rrjedhin nga sanksione gjoba dhe interesa.

B/5 SHPËRBLIMI I ADMINISTRATORIT TË FALIMENTIMIT DHE KOMITETIT TË KREDITORËVE

Duke pasur parasysh radhën e përparësisë në shpërndarje, të përcaktuar në dispozitën e sipërcituar, administratori i falimentimit ka propozuar që shpërndarja të bëhet në këtë mënyrë:

1. **Kreditori i siguruar KURTI Trans L82** të shlyhet plotësisht (100%) detyrimi ndaj tij prej 120,000,000 (njëqind e njëzet milionë) lekësh, me sasinë prej 9500 ton krom në bazë të Kontratës së Pengut, datë 18.2.2019 (nënshkruar përpara çeljes së procedurës së falimentimit).

2. **Kreditori i siguruar NELI sh.p.k.** të shlyhet plotësisht (100%) detyrimi ndaj tij prej 15,000,000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekësh, me sasinë prej 1,000 (një mijë) ton krom siç rezulton nga Kontrata e pengut, datë 18.2.2019.

3. **Kreditori i preferuar Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj** – të shlyhet detyrimi për kontributet e sigurimeve shoqërore plotësisht (100%) në shumën prej 34,945,060 (tridhjetë e katër milionë e nëntëqind e dyzet e pesë mijë e gjashtëdhjetë) lekë dhe taksa e rentës në shumën prej 8,402,197 (tetë milionë e katërqind e dy mijë e njëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë d.m.th. në masën 86.2% të totalit të detyrimit.

4. **Kreditori i procedurës së falimentimit.** Kompensimi/shlyerja e detyrimit në shumën 15,000,000 lekë ndaj kreditorit të procedurës së falimentimit KURTI Trans L82 sh.p.k. me sasinë prej 2,200 ton mineral krom të vënë peng, në bazë të kontratës së pengut datë 27.6.2022 (kontratë e nënshkruar gjatë procedurës së falimentimit), që është lidhur për garantimin e kontratës së huas datë 27.6.2022, të marrë ndaj kësaj shoqërie nga debitori NELI sh.p.k., me qëllim pagimin e punonjësve.

Ndërsa për kreditorët e tjerë të pasiguruar REDEN sh.p.k., ALBSIG sh.p.k., “Energy & Air”



sh.p.k., “Shega Trans” sh.a., “INSIG Tirana 2” sh.a. (kreditor), ALBCHROME sh.p.k. (kreditor), “Sigma Inter Albania” sh.a., Arjan Daci person fizik etj., nuk mbeten likuiditete për shlyerjen e tyre.

Me vendimin e datës 1.11.2022, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër vendosi: “1. Miratimin e raportit të administres së falimentimit të shoqërisë NEKU sh.p.k., shoqëri në procedurë falimentimi datë 20.10.2022. 2. Miratimin e kompensimit të detyrimeve, që shoqëria NEKU sh.p.k. ka ndaj kreditorëve të siguar “KURTI Trans L82” sh.p.k. dhe NELI sh.p.k., si dhe kreditorit të procedurës së falimentimit “KURTI Trans L82” sh.p.k. me sasinë e mineralit të dhënë peng sipas kontratave të pengut, të cituara në pjesën arsyetuese të këtij vendimi. 3. Miratimin e listës së shpërndarjes përfundimtare, miratimin e shpenzimeve të procedurës së falimentimit të shoqërisë NEKU sh.p.k., shpërbërimit të administres së falimentimit dhe shpërbërimit të komitetit të kreditorëve, sipas tabelave për shpërndarjen përfundimtare të masës së falimentimit, bazuar në radhën e përparësisë, të përcaktuar në ligjin nr. 110/2016, “Për falimentimin”. 4. Miratimin e transferimit të lejes minerare nr. 1482/2, datë 2.8.2010, në objektin Galeria A, me kuotë +1200, deri në nivelin e Galerisë B=1240 tek fituesi shoqëria “RAFA Group” sh.p.k. i procedurës nga marrëveshja e drejtpërdrejtë. 5. Miratimin e përfundimit të kontratave të punës me punonjësit e shoqërisë NEKU sh.p.k., shoqëri në procedurë falimentimi.”.

Gjykata vlerëson të bazuar në ligj kërkesën për përfundimin e marrëdhënies së punës me punëmarrësit e debitorit NELI sh.p.k., shoqëri në procedurë falimentimin. Gjykata e falimentimit është kompetente për të vendosur për çdo çështje, që lind si pasojë e përfundimit ose ndryshimit të kontratave të punës. Në nenin 78, paragrafi 2, të ligjit të posaçëm përcaktohet se falimentimi konsiderohet si shkak ekonomik objektiv për të përfunduar ose për të ndryshuar kontratat e punës dhe kështu përbën zgjidhje të kontratës së punës për shkak të justifikuar nga ana e punëdhënësit, në kuptim të nenit 155 të Kodit të Punës, pa sjellë pasojë ligjore për të. Duke qenë se masa e falimentimit është shitur dhe shoqëria nuk ka më aktivitet për të ushtruar, kontratat e punës me 35 (tridhjetë e pesë) të punësuarit, sipas pozicionit të punës të përcaktuar në raportin e administratorit datë 20.10.2022 dhe që konkretisht janë shtetasit: Alfred Kurti, Musa Ruçi,

Refik Spahiu, Lulzim Kurti, Ilber Gjoka, Sabrie Nika, Rakip Alla, Tufik Gjoka, Kujtim Dangri, Aqif Dangri, Edison Luku, Emri Hoxha, Erjon Gjurma, Fatmir Fiku, Dritan Puca, Nadire Murraja, Dashurie Manuka, Tahir Doda, Festim Sina, Fatmir Allmeta, Eduart Përkola, Dritan Kandri, Miftar Hupi, Artur Partalli, Ilir Balla, Albert Tançi, Besurie Veseli, Vladimir Laci, Dilber Laci, Altin Hidri, Sali Koxha, Veli Laçi, Luan Laçi, Artan Lami dhe Valbona Kola duhet të zgjidhen për shkak të ligjit.

Për sa i përket transferimit të lejes minerare, ligji nr. nr. 110/2016, “Për falimentimin”, në nenin 137, paragrafi 2, parashikon se në rast të transferimit të veprimtarisë tregtare në tërësi ose të njësisë, kontratat në të cilat debitori është palë transferohen së bashku me veprimtarinë, pa pasur nevojë për pëlqimin e palës tjetër kontraktore. Sipas kësaj dispozite “transferimi i licencave dhe lejeve administrative bëhet pa ndonjë veprim ose pëlqim të mëtejshëm, për sa kohë që nuk parashikohet ndryshe nga legjislacioni në fuqi”. Duke qenë se në rastin konkret, ndodheshim para një parashikimi ndryshe pasi në nenin 41, paragrafët 1–3, të ligjit nr. 10034, datë 15.7.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” përcakton se: “Lejet minerare, të dhëna sipas procedurave konkurruese, dhe ato, për të cilat është përfunduar një marrëveshje lehtësuese, nuk janë të transferueshme. 2. Lejet minerare, për të cilat veprimtaria minerare, sipas përcaktimeve të këtij ligji, nuk ka filluar, janë të patransferueshme. 3. Lejet e tjera minerare, të dhëna sipas procedurave të këtij ligji, janë të transferueshme vetëm pas miratimit paraprak nga ministri. Çdo transferim i kryer pa miratimin paraprak është i pavlefshëm”, Gjykata njoftoi ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë për dhënien e miratimit për transferimin e lejes minerare me shkresat nr. 316/ 28, datë 24.11.2022, datë 22.12.2022, datë 17.1.2023, datë 31.1.2023, datë 6.4.2023. Me shkresën e fundit nr. 316/28/6, datë 18.5.2023, gjykata njoftoi ministrinë se në rast vonese do të vlerësojë miratimin në heshtje të kërkesës për lejen, konform parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative.

Duke qenë se ministri përgjegjës nuk ka dhënë pëlqimin për transferimin e lejes, pas disa njoftimeve të bëra radhazi, mbështetur në nenin 97/1 të K. Pr. Administrative, në seancën e datës 8.6.2023, Gjykata vlerësoi të miratuar në heshtje aktin administrativ individual për transferimin e lejes minerare. Kjo dispozitë parashikon se nëse pala ka kërkuar në procedurën administrative nxjerrjen e një akti



administrativ shkresor dhe organi publik nuk njofton vendimin brenda afatit të përcaktuar me ligj apo akt nënligjor për përfundimi e procedurës dhe nuk njofton zgjatjen e afatit ose nuk njofton vendimin brenda afatit të zgjatur, kërkesa konsiderohet si e miratuar dhe akti administrativ shkresor i kërkuar si i miratuar në heshtje (akti në heshtje). Në mungesë të afateve të përcaktuara nga ligji i posaçëm, afati për përfundimin e procedurës administrative është 60 ditë, sikurse parashikohet nga neni 91 i K. Pr. Administrative.

Pas shpërndarjes përfundimtare, nuk rezultojnë pasuri të tjera të debitorit, prandaj, bazuar në nenin 153, të ligjit nr. 110/2016, duhet të vendoset përfundimi i procedurës së falimentimit, sipas raportit të administratorës së falimentimit “Për mbylljen e procedurës së falimentimit”, datë 31.5.2023. Shpërndarja përfundimtare sjell humbjen e personalitetit juridik të debitorit, që do të thotë se personi juridik pushon së ekzistuari si subjekt i së drejtës. Me shpërndarjen e plotë të të ardhurave, likuidimi sjell prishjen e personit juridik NEKU shp.k. Në këtë rast, administratori i falimentimit ngarkohet me detyrën për të dërguar vendimin e gjykatës së falimentimit në regjistrat përkatës, në mënyrë që të fshijë debitorin nga këta regjistra.

Për sa i përket shpenzimeve gjyqësore, këto i ngarkohen debitorit, në përputhje me tabelën, bashkëlidhur raportit të administratorit të falimentimit, datë 30.9.2022. Bazuar në nenin 48, të ligjit nr. 110/2016 dhe VKM-së nr. 197, datë 13.4.2007, “Për kushtet dhe kriteret e shpërblymit dhe rimbursimit të shpenzimeve të administratorit të falimentimit”, administratori i falimentimit shpërblehet në masën 6.5 % (gjashtë pikë pesë përqind) të masës së falimentimit të debitorit NEKU sh.p.k., domethënë 4,804,836 lekë, si dhe tarifën e suksesit 15%, që përkthehet në vlerën 720,720 lekë, të miratuar nga Komiteti i Kreditorëve. Kurse anëtarët e Komitetit të Kreditorëve shpërblehen në masën 1,376,498 lekë për angazhimin e tyre në këtë veprimtari.

Së fundi, Gjykata thekson se nëse, në çdo kohë brenda një viti nga përfundimi i procedurës së falimentimit, zbulohen pasuri të reja që i përkasin debitorit ose pretendime të mundshme për shmangie veprimesh ose identifikohen përgjegjësi të organeve drejtuese, çdo kreditor mund të kërkojë

rifillimin e çështjes së falimentimit konform nenit 154, të ligjit nr. 110/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, bazuar në nenet 125, 309 e 310, të Kodit të Procedurës Civile dhe nenet 12, 14, 153, të ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”,

VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurës së falimentimit për shoqërinë tregtare NEKU sh.p.k., me NUIS L01405006G, me seli në rr. “Pazari”, Terminali, Bashkia Bulqizë.

2. Transferimin e lejes minerare nr. 1489/2, datë 2.8.2010 (aplikimi nr. LC-7698-12-2022) nga shoqëria tregtare NEKU sh.p.k. te shoqëria tregtare RAFA GROUP sh.p.k.

3. Urdhërohet çregjistrimi nga regjistrat përkatës të shoqërisë tregtare NEKU sh.p.k., që ka humbur personalitetin juridik me mbarimin e kësaj procedure.

4. Urdhërohet botimi i një kopje të këtij vendimi për përfundimin e procedurës së falimentimit për shoqërinë tregtare NEKU sh.p.k. në faqen elektronike të gjykatës, në Bashkinë Bulqizë, në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Dibër, Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë, në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe në Fletoren Zyrtare.

5. Ngarkohet administratori i falimentimit, znj. Shpresa Breçani, për të komunikuar një kopje të vendimit për fshirjen e debitorit NEKU sh.p.k. nga regjistrat përkatës.

6. Shpenzimet gjyqësore për procedurën e falimentimit i ngarkohen debitorit.

7. Ky vendim është menjëherë i ekzekutueshëm.

8. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të arsyetuar të tij.

U shpall në Peshkopi, më 8.6.2023.

GJYQTAR
Ardit Kuka

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 192 lekë